



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.06.2022, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Flutura Aça – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidatët për plotësimin e 2 vendeve vakante për anëtarë të KDRTSH-së.

Marrin pjesë:

Flutura Aça, Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Ilir Topi, Lindita Buxheli, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Andia Ulliri, Merita Bakiu dhe Kastriot Piroli.

Mungojnë:

Blerina Gjylameti, Enslemvera Zake, Agron Gjekmarkaj.

Të ftuar:

Kandidatët:

Albert Minga,

Arian Paço,

Edmond Tullumani,

Genc Tomço,

Ilir Goci,

Kristaq Birbo,

Majlinda Rama,

Stefan Çapaliku,

Krenar Hajdëri.

HAPET MBLEDHJA

Flutura Aça – Përshëndetje, kolegë!

Fillojmë seancën dëgjimore për përzgjedhjen e kandidatëve të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit për dy vende vakante. Ju jeni njohur me kandidaturat dhe me CV-të e tyre, pasi kanë qenë të depozituar pranë sekretarisë.

Fillojmë dëgjesën me kandidatin e parë, zotin Albert Minga.

Faleminderit!

Mirë se erdhët!

Emrin jua thashë, kështu që do të bëni vetëm një përmbledhje të shkurtër për efekt regjistrimi dhe pastaj të na thoni se çfarë ofroni ju për Këshillin Drejtues. Është e vështirë t’jua themi këtë gjë juve, por gjithsesi faleminderit shumë!

Albert Minga - Quhem Albert Minga. Që në fillimet e mia kam ushtruar detyrën e regjisorit në Radiotelevizionin Publik Shqiptar për një periudhë goxha të gjatë, sa modestisht mund të them se jam regjisor i parë që kam filluar punën në një televizion profesional, në mos gabo, në vitin 1968. Kryerja e kësaj detyre më ka krijuar mundësinë që në këtë televizion, në këtë ent publik, të ushtroj të gjitha gjinitë pa përjashtim, në një aktivitet të tillë artistik, siç është televizioni. Kjo do të thotë se në hapat e parë e kam filluar me informacionin, pastaj me filmin dokumentar, me filmin artistik, me teledramën, me serialin dhe me spektaklet e ndryshme.

Ndërkohë, kjo punë nuk më ka penguar që herë pas here, bazuar edhe në faktorin kohë, të ushtroj edhe detyrën e pedagogut në Akademinë e Arteve në degën e regjisorës dhe në mjeshtërinë e aktrimit. Ndërkohë, që në fillimet e mia kam punuar disa shfaqje me Teatrin Kombëtar, duke përfunduar në kohët e sotme, në kohët moderne, të themi, ku kam punuar dy drama, të cilat them se janë mirëpritur nga publiku dhe që quhen njëra “Pamje nga ura” e Artur Milerit dhe tjetra “Filumena Marturano” e Eduardo de Filipino.

Gjithashtu, për një kohë të shkurtër, aq sa e kërkonte ligji, kam qenë për rreth 1 vit drejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar. Nuk e kreqa të gjithë mandatin për një arsye ligjore, sepse në atë kohë që të ishe drejtues i Radiotelevizionit duhej të ishe edhe anëtar i Këshillit Drejtues, detyrë për të cilin po kandidoj sot. Ajo gjë kishte një limit kohe dhe normalisht pengonte për vazhdimin e asaj detyre.

Më pas, për një periudhë prej 6-vjeçare, kam qenë në Këshillin Kombëtar të Radiotelevizionit, i cili sot quhet AMA. Aty kam pasur detyrën e zëvendëskryetarit të Këshillit Kombëtar të Radiotelevizionit.

Dy spektaklet që përmenda pak më parë i kam realizuar pasi më mbaroi mandati dhe më pas punova me teatrin. Edhe aktualisht, mbase për ju s'ka rëndësi, por kam disa projekte në duar, si me Teatrin Kombëtar, ashtu edhe me filmin. Në mënyrë tangente si *flash back* themi ne kineastët, kjo ishte biografia ime krijuese.

Flutura Aça – Një përmbledhje të shkurtër: çfarë ofroni ju për Këshillin Drejtues nëse do të zgjidheshit, në bazë të përvojës tuaj?

Albert Minga – E kuptoj.

Flutura Aça – Një përmbledhje të shkurtër, i dashur regjisor.

Albert Minga – Unë, të them të drejtën, duke qenë krijues, besoj se nuk jam subjektiv, se kërraba më heq në një drejtim. Radiotelevizioni Publik Shqiptar prej vitesh vuan nga drejtimi artistik i institucionit. Vërtet është një paradoks, që përpara ndryshimit të sistemit krijuesit kishim ato vështirë, që janë të pakuptimta për t'i thënë, por sot që ekzistojnë mundësitë për t'u marrë me të gjitha gjinitë, me të gjitha veprat, sot në Radiotelevizionin Publik Shqiptar, nuk ka një departament që të merret me prodhimin e filmit, spektaklit, teledramës. Domethënë, unë dhe shokët e mi, në qoftë se jemi bërë regjisorë, aq sa jemi bërë, jemi bërë pikërisht sepse organizativisht kemi pasur mundësinë të ushtrojmë profesionin tonë duke u marrë me këto gjini. Sot dhe prej goxha vitesh ky departament, fatkeqësisht, në Radiotelevizionin Shqiptar mungon. Për ta bërë më të qartë dhe jo për ta dramatizuar, por për të qenë më konkretë, unë po them një gjë, edhe ne që kemi qenë pak më përpara Televizionit, kjo gjendje na krijon një ndjesi dhe një trishtim në vetvete. Sot Televizioni, administrativisht, në mos gaboj, ka në dispozicion 20 regjisorë. Atëherë, unë po marr kurajën të them që, pothuajse nuk ka asnjë regjisor, në sensin e potencialit të tyre krijues.

Domethënë, Radiotelevizioni Shqiptar sot nuk ka çfarë t'i ofrojë mediumit kinematografik, televiziv dhe teatral. Për shembull, paradoksi është se ka vite që është vetëm një aktivitet në televizion, Festivali i Radiotelevizionit, të cilin në kohën time, profesionalisht nuk e quanim ndonjë kënaqësi të madhe për t'u marrë, sepse një njeri që e njeh kinematografinë dhe televizionin, regjisorit nuk i ofron shumë mundësi, për të qenë realistë. Sot, megjithatë ka vite, që Festivali i

Këngës në Radiotelevizion, i vetmi aktivitet i përvitshëm, i sanksionuar, nuk ka asnjë regjisor të tijin. Kjo është e trishtueshme, është e jashtëzakonshme.

Nga Radiotelevizioni Shqiptar, një pjesë jo e vogël e televizioneve të tjera e ushtrojnë profesionin e tyre me moderatorë që janë produkti ynë, i shkollës tonë profesionale, por sot Radiotelevizioni Publik Shqiptar nuk ka një njeri të drejtojë Festivalin, të drejtojë biseda interesante për artin, për kulturën, pa dashur të fyej asnjëri. Ata që drejtojnë sot programet, që kanë vokacion krijues për letërsinë, për dramaturgjinë, për teatrin dhe për televizionin, modestisht po them, janë të tillë që, një krijues po të shkonte pranë tyre, nuk besoj se do të ndihej komod për t'u marrë me analizën e veprës së tyre. Kërkoj ndjesë, mbase jam edhe subjektiv, por unë nuk mund të hedh baltë mbi një institucion në të cilin jam pjesë, por po i them këto gjëra, me idenë se çfarë mund të bëhet në Televizion.

Problemi i dytë që e kam thënë edhe në nja dy vende të tjera, në disa biseda dhe në disa shkrime, është që me urgjencë të madhe, në mënyrë institucionale, me instrumente ligjore duhet të merremi me rifreskimin e arkivit të Televizionit Shqiptar.

Nuk e them thjesht se aty kam teledramën e parë shqipe “Zekthin”, që e kam realizuar në vitin 1974 me Teatrin e Shkodrës dhe dua që të rinovohet, por flas për gjëra të tjera, që s'kanë të bëjnë...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon.)

Digjitalizimi është një koncept i gjerë. Po ju them një gjë: në atë kohë, ne kemi xhiruar me teknologjinë e pelikulës, me film 16 milimetra. Domethënë, për Televizionin standardi ndërkombëtar ka qenë 16 milimetra, kurse për Kinostudion filmat xhiroheshin me 53 milimetra, kaq ishte madhësia e pelikulës së filmit. Fillimisht kemi xhiruar me 16 milimetra negativ edhe në mënyrë elektronike, për shpejtësi kohe, për operativitet, për kronikat inverttohej filmi, kalonte direkt në pozitiv. Më pas xhirohej me invers, direkt në pozitiv dhe pastaj u bë në formatin klasik; vepra e mbaruar kalonte direkt në negativ, siç kalonte një film i Kinostudios.

Më vonë, me shpikjen e pajisjeve të elektronikës, domethënë, në këtë drejtim Radiotelevizioni Shqiptar ka qenë bashkëkohor, si kudo në botë erdhën kamerat elektronike, erdhën edhe kamerat elektronike portative, erdhën autobusët, por problemi qëndronte te regjistruesit. Pra, këtë sinjal që po marrim ne nga mbledhja e komisionit, në atë kohë regjistrohej me një shirit, i cili për kohën ishte nga më të mirët, nga firma amerikane *Ampex*. Sot ky film *Ampex* nuk ekziston, pra do të thotë që të bëhet një rifreskim i arkivës, që krijimtaria të hidhet në pajisje

me parametrat e sotshëm, se flasim për mijëra dhe për mijëra programe; flasim për dëshmi dhe për dëshmi të cilat i vlejné historianëve, shkrimtarëve, artistëve, krijuesve. Kështu që, këto materiale duhet të rimëkëmben, që njerëzit t’i shohin dhe t’i përdorin.

Për shembull, mbase nuk është krahasim vulgar ky që do të bëj, por në Arkivin e Shtetit ka materiale me vlerë, të cilat kur i shikon duhet të kesh një lloj syzesh që t’i lexosh dhe t’i deshifrosh. Pra, t’i kesh dhe mos i përdorësh materialet është një fatkeqësi e madhe për një krijues, që do të shikojë se kush ka qenë Noli, Fishta dhe të tjerë. Ky është problem kombëtar. Çfarë kërkon kjo? Kjo kërkon një buxhet, në gjykimin tim, enkas, të specifikuar për rinovimin e arkivit. Kjo do të sillte një ndryshim, sepse gjithë ato filma, gjithë ato dokumentarë, do të përdor një term të ashpër, ta shpifin kur i sheh, janë gjithë grana, janë në gjendje mizerabël, janë jashtë parametrave. Aparati që përdoret sot në televizion nuk i pranon, i nxjerr jashtë, për t’i transmetuar. Kështu që, në këtë kuptim them se kjo është goxha e rëndësishme.

Mendoj se këto janë dy pikat, për të cilat do të përpiqem, nëse do të kem mundësinë të jem anëtar i Këshillit brenda kuadrit ligjor, brenda mundësive që ofron, sepse nuk mund të bëj gjëra që janë jashtë kapacitetit të një anëtari të thjeshtë. Pra, do të përpiqem të jap kontributin tim modest në këtë drejtim.

Flutura Açka – Zoti Minga, faleminderit shumë!

Ndoshta, ndonjëri nga kolegët ka pyetje për ju.

Nuk ka pyetje. Ishit i qartë, thonë kolegët.

Albert Minga - Faleminderit shumë!

Punë të mbarë!

Flutura Açka – Faleminderit juve!

Mbarësi dhe suksese!

Atëherë, ftojme kandidatin e dytë, ju lutem.

Përshëndetje!

Mirë se erdhët, zoti Paço!

Për efekt regjistrimi duhet të thoni emër, mbiemër dhe të bëni një prezantim sa më të shkurtër të CV-së tuaj, si dhe të na thoni se çfarë i ofroni Këshillit të Drejtues të Radiotelevizionit, nëse do të zgjidheshit në të.

Mund ta shtypni butonin, ju lutem dhe të vazhdoni.

Arian Paço - Emri im është Arian Paço. Kam lindur në Tiranë më 23.10.1957. Kam studiuar për violinë që në 8-vjeçare, pastaj në Liceun Artistik, me radhë në Akademinë e Arteve, sot Universiteti i Arteve. Në vitin 1981 kam mbaruar Akademinë e Arteve dhe më pas kam filluar punë në Teatrin e Operës. Kam punuar për një periudhë 9-vjeçare në Teatrin e Operës dhe, në të njëjtën kohë, në vitin 1983 kam filluar punën si pedagog i jashtëm në Liceun Artistik dhe në vitin 1985 si pedagog i jashtëm në Akademinë e Arteve, vend në të cilin punoj edhe sot. Kam një aktivitet të pasur si pedagog. Bëhen rreth 60 studentë që janë diplomuar në klasën time në instrumentin e violës. Njëkohësisht, kam një aktivitet të pasur artistik me koncerte, recitale brenda dhe jashtë vendit. Kam kryer një sërë kursesh, kualifikimesh dhe master klasash jashtë shtetit. Kam kryer disa detyra administrative në Universitetin e Arteve, të cilat vazhdoj t'i kryej edhe sot. Me pak fjalë, kjo është CV-ja ime.

Duke pasur parasysh që kam një periudhë shumë të gjatë që operoj në fushën e artit, kulturës dhe të edukimit, mendoj që të gjithë këtë eksperiencë të grumbulluar ndër vite, mund ta vë në funksion të Këshillit të Drejtues të Radiotelevizionit. Gjithashtu, mbaj edhe titullin e Profesorit.

Flutura Açka – Problemi është, çfarë shikoni ju që nuk shkon mirë në Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit dhe çfarë mendoni ju se duhet përmirësuar?

Arian Paço – Unë nuk di se çfarë shkon mirë. Unë vetëm thjesht ndjek programet, nuk e di se ç'bëhet brenda, sepse nuk jam pjesëtar i brendshëm i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit, por besoj që me aq sa e kam parë, me aq sa e kam ndjekur, sepse në treg ka shumë kanale televizive që ofrojnë lloj- lloj programesh, mendoj që duhet të ketë më tepër programe edukative me karakter artistik, duke pasur eksperiencë edhe nga jashtë shtetit. Për shembull, nëse do të bëja një paralelizëm, fjala vjen, kur kam qenë në Angli vite më parë, kishin disa stacione të radios dhe të televizionit të dedikuara vetëm për muzikën klasike dhe në çdo orë që e hapje televizorin, kanali 1 ose kanali 2 i BBC-së ishin totalisht të dedikuara ndaj muzikës klasike, nuk kishte asnjë lloj programi tjetër, asnjë lloj lajmi, por vetëm koncerte live, interpretime nga më të rëndësishmet, nga më prestigjiozet. Kështu që, në këtë kuptim mendoj se ndoshta Radiotelevizioni Shqiptar dhe Radio Tirana, përtej kanalit të dedikuar që ka Radio Tirana me muzikë klasike, ndoshta Radiotelevizioni Shqiptar duhet të kishte më shumë emisione edukative në fushën e artit dhe të kulturës, pse jo edhe emisione të gatshme me koncerte klasike.

Fjala bie, të mos jepen vetëm një herë në vit, si Koncerti i Vitit të Ri që transmetohet direkt nga Vjena, sepse tregu ka plot koncerte. Pse jo, fjala vjen, siç është “RTSH Arsim”, RTSH-ja mund të ketë një kanal, ku japin mësim pedagogë të ndryshëm se si mësohet një instrument, duke qenë se kjo gjë përhapet tani. Në kohën time funksiononin pallatet e pionierëve, të cilët merreshin me edukimin muzikor të fëmijëve, për të mësuar një instrument apo për të marrë pjesë në një kurs pikturë, krahas kurseve të tjera. Në kushtet kur shkollat e muzikës janë limituar deri diku edhe në Tiranë, edhe nëpër rrethe, ndoshta mund të ishte Radiotelevizioni Shqiptar një formë e edukimit me kurse pianoje, kurse kitare e të tjera. Pra, kjo mund të ishte një formë, por përgjithësisht do të insistoja në fushën e edukimit të artit dhe të kulturës. Kjo është ideja ime.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Paço!

Në goftë se kanë kolegët e mi ndonjë pyetje për ju?

Po, zoti Koçi.

Petro Koçi – Nga veprimtaria dhe përvoja e deritanishme, ka ndonjë moment kur keni bashkëpunuar me mediat, qofshin edhe ato private? E kam fjalën, që t’ju ketë krijuar mundësinë për të njohur çdo të thotë media, në kuptimin pak nga brenda?

Arian Paço – Jo, nuk kam pasur. Unë kam qenë për intervista nëpër media, por jo për bashkëpunime në këtë drejtim, siç thoni ju. Kështu që, me thënë të drejtën nuk kam ndonjë eksperiencë shumë të madhe, por për intervista dhe për koncerte kam qenë vazhdimisht në media, por në këtë drejtim që thoni ju, jo nuk kam pasur ndonjë bashkëpunim.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Paço!

Suksese!

Kalojmë te kandidati tjetër, zoti Tullumani sipas listës.

Përshëndetje, zoti Tullumani!

Mirë se erdhët!

Për efekt të regjistrimit duhet të thoni emrin, mbiemrin dhe të bëni një CV të shkurtër, sa më të përmbledhur dhe, më pas, të na thoni se çfarë ofroni ju nëse do të zgjidheshit kandidat i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, si dhe çfarë mendoni se duhet përmirësuar apo edhe gjëra të kësaj natyre.

Edmond Tullumani - Unë quhem Edmond Tullumani. Kam mbaruar për muzikë, pikturë dhe juridik. Pra, kam një CV-i që i përket edhe artit, edhe një lloji tjetër drejtimi. Kam punuar në Teatrin e Operës dhe Baletit prej 17 vjetësh. Kam qenë edhe drejtues në Pallatin e Kongreseve.

Njëkohësisht jam edhe producent, në shumë aktivitete, ku më i njohuri është koncerti “3 tenorët”. Pothuajse bëhen 20 vjet të këtij aktiviteti, të cilin e festova vitin që kaloi. Ky koncert, përveç shumë aktiviteteve të tjera, ka bërë një emër të madh jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë, duke sjellë tenorë nga e gjithë bota, si dhe artistë me emra të mëdhenj, të cilët kanë propaganduar në mënyrën më perfekte, si një ambasador i dytë, në të gjithë botën artin shqiptar.

Për sa i përket Televizionit, pretendoj që jam një nga bashkëpunëtorët më seriozë të këtij Televizioni. Gjithmonë kam pasur dëshirë që të bashkëpunoj jo me televizionet private, por me Televizionin shtetëror, të cilin e kam quajtur një industri të madhe, që mund të bëjë gjëra të mrekullueshme për publikun. Gjithashtu, jam edhe njohës shumë i mirë i teknikës; e kam pasionin tim. Njëkohësisht, programet që i kam ofruar Televizionit Publik Shqiptar, kanë qenë nga ato elitaret, më të mirat dhe me partneritet serioz. Pikërisht, duke e njohur nga afër këtë institucion, kam pasur gjithmonë dëshirën që të kontribuoj në të. Nuk e dua këtë si një pozicion për efektin për sa u përket produksioneve, por e dua që të jap kontributin tim me përvojën që kam për sa u përket emisioneve, kanaleve, teknikës dhe menaxhimit sa më të mirë të këtij institucioni; jo se kam vërejtje, por dua të ecë përpara. Ne jemi mësuar të bëjmë vërejtje, por unë nuk kam vërejtje, por dëshirën që të eci përpara. Për shembull, një nga dëshirat e mia, kur më kanë pyetur për orkestrën e Radiotelevizionit, kam thënë se është një aset i mrekullueshëm që kemi, është një vlerë të kesh një orkestër të tillë, siç është orkestra e Radiotelevizionit, por duhet menaxhuar. Ajo mund të krijojë asete të mrekullueshme për regjistrime filmash, për regjistrime të ndryshme; mund të nxjerrë edhe të ardhura. Njëkohësisht, në qoftë se unë do të kem fatin të jem pjesë e këtij Këshilli, një pikë tjetër është arkiva e Radiotelevizionit Publik Shqiptar, është fatkeqësi...Nuk ka rëndësi se cilës periudhë i përket ajo arkivë, por ka rëndësi se çfarë ajo mbart. Pra, po të digjitalizohej, do të ishte një nga gjërat më kryevepër që mund të bëhej në Radiotelevizion. Pastaj, dua të jap kontributin tim edhe për programe të mirëfillta elitare dhe cilësore. Këto ishin në përgjithësi, që të mos ju vonoj.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Tullumani!

A kanë kolegët pyetje?

Zonja Zhupa.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Në fakt, për mua është kënaqësi e veçantë kandidatura juaj për këtë pozicion, për shkak se e them pa komplekse që jam një ndjekëse e punës suaj dhe e aktivitetit tuaj, qoftë edhe me atë që

ju përmendët aktivitetin e përvitshëm “Tre tenorët”, një aktivitet që i jep Radiotelevizionit Shqiptar një natyrë elitare, një aktivitet i përvitshëm, i cili shoqëron ditët e para të janarit me festat e fundvitit që organizon edhe Radiotelevizioni Shqiptar. Kështu që ju jam mirënjohëse, në kuptimin e asaj që i ofroni publikut shqiptar. Mendoj se kandidatura juaj realisht u jep vlerë këtyre kandidatave dhe këtij pozicioni. Dua t’ju pyes vetëm për diçka në lidhje me atë që si e shikoni ju aktivitetin artistik, që ofron sot Radiotelevizioni Shqiptar, pra programacionin artistik që ofron RTSH-ja dhe a do të ishit ju një nga mbrojtësit dhe një nga zërat për ta pasuruar këtë programacion, sepse në dëgjuesën që ne patëm me drejtuesit e Radiotelevizionit dhe me kryetarin e Këshillit, ata ngritën shqetësimet për mungesën e një variatiteti të tipit, siç është “Portokallia”, apo variete në televizionet e tjera private që Radiotelevizioni Shqiptar i ka gati të pamundur për t’i realizuar edhe nga aspekti financiar, sepse kushtojnë.

Faleminderit!

Flutura Aça – Faleminderit, zonja Zhupa!

Zoti Tullumani.

Edmond Tullumani – Faleminderit për vlerësimin!

Pikërisht për sa u përket pyetjeve tuaja, jam shumë dakord për ato që ju keni konstatuar dhe them se aty ka nevojë për menaxhim dhe unë gjithmonë aty e vë theksin. Me sa di, më duket se është momenti për zgjedhjen e drejtorit Artistik. Them se Televizioni Publik me atë orkestër, me mundësitë që ka, mund të bëjë perla. Unë e marr që nga siglat. Siglat duhet të prodhohen nga vetë televizioni publik, sepse orkestrën e ka, studiot i ka. Pse duhet “të vjedhë”? Pse duhet të marrim sigla të huaja? Ne mund të bëjmë perla; siglat tona mund të jenë të veçanta, pasi orkestrën e kemi, studion e incizimit e kemi, profesionistët i kemi. Pra, këto sigla duhet të jenë të veçanta që të njihen se janë produkt i RTSH-së. Televizionet private mund t’i bëjnë si të duan, kurse këtu mund të them se kjo duhet të jetë kërkesë. Kam pasur fatin që kam qenë disa herë në orkestrën e radiotelevizionit në Slloveni, ku kishin arritur të incizonin edhe muzikë filmash të Hollivudit, pra duhet të ngulim këmbë edhe te cilësia, e cila ishte shumë e madhe dhe u interesonte t’i incizonin atje për filmat. E nisim që këtu, më pas janë siglat që duhet të pajisen, janë studiot e ndryshme që duhet të ndahen. Brenda orkestrës mund të krijohen formacione nga më të ndryshmet, që nga kuintet, kuartet, sestet, sepse është e gjithë orkestra. Aty mund të bëhen orkestrime të vogla, të cilat janë lëvizëse dhe mund të pajisen... Besoj se e keni parë mirë të “Portokallia”. Portokallia është një program shumë i bukur. Më falni, nuk e kam për të bërë krahasime televizionesh. Unë

vij për Televizionin Publik Shqiptar. Ka një orkestër atje dhe ato gocat e orkestrës kanë qenë gocat tona të Akademisë së Arteve dhe kanë shkuar atje për interesat e tyre, por ajo është punë tjetër, por këtë gjë televizioni publik e ka të mundur dhe mund të bëjë me to një orkestër të paparë, sepse janë edhe të punësuar. Pra, ka shumë gjëra që mund të bëhen, por edhe janë bërë shumë gjëra dhe programin nuk e ka të keq. Mundohen, por do një zyrë menaxhimi me kontakte nga jashtë, se mund të vijnë elementë shumë më të mirë me dëshirën për të bërë brenda shtëpisë.

Kaq kisha.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Tullumani!

Zoti Koçi ka një pyetje për ju.

Petro Koçi – I dashur Edmond, nëse më lejon që të të thërras në emër, të përshëndes dhe e vlerësoj faktin që kandidoni për të qenë pjesë e Këshillit të Radiotelevizionit Shqiptar. Siç dihet, në ligj Këshilli është monitoruesi i televizionit, si aspekt ekzekutiv, pra ju vetë jeni në rolin e një producenti, të një menaxheri eventesh artistike, që kulmon me “Tre tenorët”, ku edhe vetë e kam shijuar, qoftë në sallë, qoftë në transmetime televizive. Madje, edhe kur ritransmetohen, të japin sërish të njëjtat emocione dhe, realisht, dua t’ju përgëzoj për këtë gjë. Ju, familjarisht, i përkisni një komuniteti artistik; kjo, me sa duket, rrit energjitë tuaja dhe dashurinë për artin. Besoj se është shumë e rëndësishme që ju ta vazhdoni këtë gjë, pra që të vazhdojë projekti “3 tenorët”, që për mua është më e rëndësishme sesa të qenit ose jo anëtar në një bord apo në një këshill, qoftë edhe ky i Radiotelevizionit Shqiptar. Domethënë, duke qenë atje, a mund t’ju krijojë kjo, në kuptimin juridik dhe moral, ndonjë problem në kuptimin e konfliktit të interesit, duke tentuar që edhe këtë lloj spektakli ta transmetojë Televizioni Shqiptar?

Flutura Açka - Faleminderit, zoti Koçi!

Urdhëroni, zoti Tullumani!

Edmond Tullumani – Faleminderit, zoti Koçi!

Përpara se të filloj, dua t’ju bëj një falënderim, sepse është rasti i parë që më jepet që t’ju falënderoj, se ka kohë që jeni mbështetës i koncerteve, madje keni qenë mbështetës edhe moralisht me ne artistët në kohë të vështira. Prandaj, ju falënderoj për përkrahjen!

Është shumë e drejtë kjo që thoni ju, por unë në të gjithë investimin tim kam pasur fatin të kem në krahun tim vajzën e artistit, të nderit të kombit, Ramiz Kovaçi, e cila është koka për sa u përket projekteve të mia. Dihet që vajza ka karrierën e saj, por në këtë rast unë kam bërë vetëm anën artistike, gjë që do ta bëja me shumë qejf edhe për TVSH-në. Nuk është asnjë lloj konflikti,

përkundrazi unë do të luftoj më shumë që t'i ofrohen televizionit publik gjëra me vlerë, ose t'i bëj atje brenda. Unë nuk kam vuajtur kurrë për emër personal. Thjeshtësia ime është kënaqësia që ndiej për muzikën dhe kur dëgjoj fjalë, siç i dëgjoja nga ju. Kur dal, publiku është i lumtur, tani që po vija, do të më falni, para disa ditësh bëra një produksion me vajzën për sa i përket muzikës qytetare shqiptare, me 8 pjesë, të filmuara nga vendet më brilante që ka Shqipëria; shumë thjesht këngët: “Zare”, “Asaman, o trëndafil çelës”; kënga shkodrane “Dashnor t’u bëra” e të tjera, thjesht perlat më të bukura që ka Shqipëria ia dhamë publikut, dikush më tha: “Faleminderit për atë gjë, - nuk e njihja fare personin. Mirë që po presim gjëra të tjera, por ajo ishte një perlë, sepse jemi lodhur me këto “unë të dua dhe ti më do, tra-la-la” dhe në fund fare tallava”. Por nuk kam çfarë të them. Unë dua të kontribuoj me një gjë, madje unë heq dorë që në momentin e parë dhe emrin nuk e dua asgjëkund, vetëm t’i marrë Televizioni Shqiptar me orkestrën e tij, pse duhet... Unë ku ta gjej t’i furnizoj ata, t’ua rris emrin atyre, se më rritet vlera edhe mua.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Tullumani!

Ju thatë tra-la-la, por ajo është mirë, por t’i kushtosh këngë kokainës! Ne kemi këngë për kokainën!

Zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zoti Tullumani!

Dua të bëjë një ndërhyrje të vogël në lidhje me këtë që parashtrou zoti Koçi për konfliktin e interesit, si anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Në fakt, për mua, nuk përbën konflikt interesi, pasi edhe anëtarë të tjerë konkurrojnë me projekte në Televizionin Shqiptar dhe aktualisht janë anëtarë të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit. Madje, edhe drejtuesi i Radiotelevizionit aplikon vetë për projekte brenda televizionit, por e mirëpres shqetësimin e kolegut Koçi dhe e ftoj që ne të shqyrtojmë konfliktin e interesit brenda Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, duke i marrë emrat një më një, meqenëse jemi komisioni përgjegjës dhe meqenëse maxhoranca e ka shqetësim konfliktin e interesit. Pra, përtej emrit tuaj, në një seancë tjetër me propozimin tonë, ose timin, do të marrim në shqyrtim konfliktin e interesit brenda Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar dhe në atë shqetësimin tim kam frikë se do të gjejmë shumë anëtarë ose disa anëtarë që kanë konflikt të pastër interesi; jo ju, ata që konkurrojnë për projekte, aq më tepër projekte që janë reflektimi i kulturës dhe i asaj çka ne duhet t’i përcjellim shoqërisë shqiptare nëpërmjet televizionit dhe programeve artistike. Kam vetëm një pyetje, meqenëse mora fjalën dhe nuk dua të dukem sikur dua të kundërshtoj zotin Koçi: ju dëgjoja për

ato dëshirat, jam shumë dakord me dëshirat dhe zoti Koçi e përcaktoi që raporti i Këshillit, në raport me mënyrën si vepron ekzekutivi, nuk ka shumë kompetenca. Ju mendoni se në angazhimin tuaj si anëtar, do të detyroni ekzekutivin, drejtorinë që të shtojë programacionin, të shfrytëzojë arkivin, siç thatë ju? A mendoni se i keni këto kompetenca dhe mendoni se do ta ushtroni me kaq forcë detyrën tuaj si anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar? Domethënë, a keni një njohuri për këtë marrëdhënie, sepse ka pasur shumë shqetësime nga Këshilli Drejtues që nuk ka ato kompetenca që duhet të ketë, në raport me drejtimin e Radiotelevizionit Shqiptar?

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Boçi!

Zoti Tullumani.

Edmond Tullumani – Faleminderit!

Edhe një herë dua të theksoj se për sa i përket personit tim, në momentin që unë do të kem të bëj me Radiotelevizionin Publik Shqiptar, nuk do të ketë asnjë lloj konflikt interesi. Këtë unë nuk e njoh, sepse thashë që jam njeri që merrem edhe me pikturën, kam 500 piktura, kam kohë që t'i kushtoj vetes gjëra që, jashtë konfliktit, do të jenë më të bukura se ato me konfliktin, sepse nuk më shijojnë ashtu, por njerëzit e tjerë me të cilët bashkëpunoj, mund të bëjnë projekte, është e drejtë e tyre.

Unë kam një natyrë që kudo ku kam qenë, nuk kam parë se kush është personi, madje kam pasur raste që në sallën time, kur bëj koncerte, nuk shikoj kush hyn dhe se cili është publiku; për mua publiku është një. Nuk ka rendësi fare, edhe televizionin unë e shikoj me këtë sy. Nuk shikoj se projektin e ka sjellë filani. Unë shikoj: në qoftë se një projekt është për mirë, do të luftoj që ai projekt të mbështetet. Të mos shikohet që projekti nuk është i mirë, por për arsye të X apo Y duhet të mbështetet; këtu mund të jetë konflikti me drejtuesit çdo gjë. Në natyrën time nuk jam konfliktual, përkundrazi, për pak kohë sa kam pasur një pozicion, besoj se e kam justifikuar mënyrën dhe pretendoj se kam qenë në parametrat më optimalë të marrëdhënieve, por varet nga drejtuesit. Unë do ta bëj luftën time për sa i përket gjësë së bukur. Unë do të luftoj për gjënë e bukur, kurse gjërat e tjera nuk më interesojnë.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Tullumani!

Edmond Tullumani – Faleminderit!

Flutura Açka – Vazhdojmë me kandidatin e radhës.

Ju lutem, kolegë, që të vendosim një raport të drejtë për kohën për secilin, pasi jemi më shumë për secilin.

Zoti Genc Tomço.

Zoti Tomço emër, mbiemër, një CV të shkurtër, të përmbledhur, dhe çfarë i ofroni, nëse do të zgjidheni, Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar?

Faleminderit!

Genc Tomço – Jam Genc Tomço, inxhinier, specialist i televizionit me stazh pune 40 vjet në RTSH. Kam aplikuar për këtë pozicion që në krye të herës, pra që prej vitit 2018, kur u shpallën vakancat. Arsyeja për të cilin aplikoj është e kuptueshme, për shkak të informacionit të madh që kam në këtë fushë, të shkollimit dhe trajnimit të shumtë që kam kryer gjatë gjithë jetës sime në fushën e televizionit, digjitalizimit dhe më gjerë. Shpenzimet për specializimet kanë arritur shumën 130 mijë euro. CV-ja profesionale lidhet me zhvillimin e teknikës nga stadi eksperimental, që kam shkuar në fillim, televizionit me ngjyra dhe në transmetimin satelitor digjital. Kontributi im fillon me mbulimin e territorit me sinjal televiziv, pasi isha i pari që me iniciativën time prodhova përsëritësin e parë televiziv profesional, i cili u bë modeli për t'i prodhuar në vend të gjithë repetitorët. Atëherë një repetitor kushtonte 5 mijë dollarë, 4 mijë dollarë, kurse unë e prodhova me 350 dollarë, pra 250 repetitorë herë 4000 mijë dollarë, i bie afërsisht 1 milion e ca dollarë përfitim. Krijova shkollën e parë teknike të televizionit në RTSH, nuk kishte teknikë televizioni, pra punova, ngrita shkollën teknike, ku të gjithë mësuan se çfarë është televizioni bardhë e zi, çfarë është televizioni me ngjyra dhe çfarë është teknika shifrore. Teknika shifrore u fut në RTSH, shumë veta nuk e dinë, që prej vitit 1973, kur u ble pajisja e parë digjitale, që ishte një kompjuter, por me dimensione të mëdha për titrimin në RTSH, ku titroheshin programet dhe filmat. Që në fillim e vura në punë dhe bëra mirëmbajtjen e saj, derisa mbaroi si pajisje.

Flutura Açka – Zoti Tomço, më falni që po ju ndërpres, kolegët janë njohur me CV-në tuaj, sepse e kanë pasur të depozituar në sekretari. Prandaj sa më shkurt, sepse më shumë jemi të interesuar çfarë ofroni ju. Kjo është gjeja për të cilën jemi më shumë të interesuar.

Genc Tomço – Pra, një përfitim i madh ishte digjitalizimi i transmetimeve satelitore në një kohë rekord, sepse solli shumë përfitime të mëdha. Që prej vitit 2018, kur nisa aplikimet për anëtar të Këshillit Drejtues, studiova me kujdes skemat e ofruara nga firma *Rod&Shvarc*, atë që ka tani RTSH-ja. Pra, e njoh mirë skemën, por ajo që më ka tërhequr më shumë aty, është se çfarë ngritjesh profesionale kanë njerëzit që e përdorin dhe sa kushton mirëmbajtja e pajisjes.

Mirëmbajtja e pajisjes duhet ta dini, sipas asaj që e kam arritur unë, është 7 milionë euro për 4 vjet. Duhet t'i harxhojmë këto, duhet t'i fitojmë, kush duhet të ngrihet, kush duhet të bëhet, në mënyrë që... Kur kemi bërë televizionin me ngjyra, çdo gjë e kemi bërë vetë, që nga instalimi, që nga projekti, që nga mirëmbajtja, asgjë e huaj, as pjesë këmbimi, asgjë, përfitimet ishin të mëdha.

Synimet e tjera. Në bashkëpunim me anëtarët e Këshillit Drejtues dhe kryetarin, duhet të përgatitet një program pune me profilin drejt teknikës. Në këtë rast duhet bërë rikonstruksioni i studiove dhe i pajisjeve, duhet të nxirren problemet nga bashkëbisedimet që do të bëhen edhe me personelin teknik. Si ndiqen këto probleme për t'i realizuar? Si do të organizohet ngritja profesionale, sipas vendit të punës, siç bëhet në televizionet e tjera të botës? Në këtë drejtim, ka shumë për të mësuar. Synimi im kryesor është digjitalizimi i materialeve të arkivit, duke u ofruar eksperiencën e fituar, kryesisht në Arkivin Qendror të Filmit, ku kam kontribuar 20 vjet, kam mirëmbajtur pajisjen falas, domethënë një pagesë 250 milionë lekë dhe kanë përfituar nga shërbimi im. Pra, instalova pajisjen, e mirëmbajta gjatë 20 vjetëve dhe kjo ka ngritur shumë aftësinë time për digjitalizimin e materialeve. Kam marrë pjesë edhe në digjitalizimin e materialeve në RTSH-Kosovë. Po ashtu, kam asistuar në fazën përfundimtare të digjitalizimit të filmit “Përrallë nga e kaluara” në Hungari. Bashkë me teknikët arritëm një cilësi të paparë të materialit, ndërkohë që edhe drejtorin e kam tani mik, *Pinter Gabor*, i cili është i gatshëm të na ndihmojë për çdo gjë, nëse do të më jepet rasti të jem në Këshillin Drejtues.

Për të gjitha aftësitë që kam, e shoh me vend pjesëmarrjen në Këshillin Drejtues të RTSH-së, e shoh si diçka zbavitëse për mua, se jam si në shtëpinë time, 40 vjet nuk janë pak.

Flutura Açka – Faleminderit!

Nuk e di nëse kolegët kanë diçka?

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Zoti Tomço, ju prekët një problem themelor të menaxhimit të RTSH-së, që e dëgjuam pak edhe nga drejtuesit e tij në këtë sallë, që ka të bëjë me mirëmbajtjen e rrjeteve frekuencore, që kanë një kosto shumë të madhe, 7 milionë euro. Shuma nuk është relatuar këtu, por një pjesë e madhe e shpenzimeve të RTSH-së shkonte për mirëmbajtjen e dy rrjeteve frekuencore. Në dijeninë time, pasi kam qenë pjesë e debatit për rrjetet frekuencore, në kontratën e parë të *Rod&Shvarc* përcaktohej se mirëmbajtja do të ishte në ngarkim të kompanisë për një periudhë post 5-vjeçare, pas mbarimit të instalimit të rrjeteve frekuencore. Këtë gjë ua kam kërkuar si informacion drejtuesve të RTSH-së, të Këshillit Drejtues të RTSH-së dhe vetë drejtorit, edhe

përgjegjësit të bordit financiar apo të administrimit, të cilët, në mos gaboj, nuk kishin dijeni. Tani nga ju, meqenëse jeni i kësaj fushe, ka ndryshuar kontrata? Sot RTSH-ja e mirëmban vetë, apo kontrata vazhdon dhe firma *Rod&Shvarc* nuk përgjigjet?

Genc Tomço – Me sa di unë, kjo është konfidenciale, kontrata e dytë është bërë si e para, 7 milionë e gjysmë, pra vazhdojnë edhe 4 vjet 7 milionë të tjera. Bëhet fjalë për mirëmbajtjen. Këtu ngul këmbë, prandaj duhet të jetë teknik aty. Nëse do të ishte teknika që në vitin 2018 kur kam aplikuar, do të ishte ndryshe situata në RTSH. Ta themi tamam, ndërmjet nesh.

Flutura Açka – E qartë! Jo ndërmjet nesh, sepse këtu po flasim në publik. A e keni ngritur ndonjëherë zërin si specialist, se këtu është i gjithë problemi në Shqipëri? Specialistët nuk e ngrenë zërin asnjëherë kur vjen puna te çështjet e tyre specifike, as urbanistët, as ata të territorit, asnjë. Specialistët janë problemi në këtë Shqipëri, që nuk e ngrenë zërin kur duhet, në mënyrë që t'i korrigjojnë edhe politikanët.

Genc Tomço – Ju kuptoj shumë mirë. Unë kam qenë person që e ngrija zërin dhe nuk kisha frikë nga njeri. Kur kam punuar atje, ka qenë pak e frikshme të ngrije zërin aq shumë, por në projektin madhor, që ishte televizioni me ngjyra, vetë Ramiz Alia më ka thirrur në zyrë bashkë me Agron Çobanin, drejtorin e RTSH-, dhe më kanë ngarkuar: “Do të merresh me këtë punë. E duam shpejt”. I tha edhe drejtorit: “Mos e prekni këtë person, që të vazhdojë punën”. Atë punë që më ngarkohej, unë e çoja deri në fund.

Përfitimi i RTSH-së nga kontributi im, nga iniciativa, se mund të qëndrosh aty të bësh punën, por nuk ke iniciativë, është 7 milionë euro. Me 7 milionë euro blije televizionin me ngjyra. Është dhuratë nga ana ime. I kam shlyer edhe rrogat që kam marrë, edhe specializimet. Jam krenar që aplikoj.

Flutura Açka – E kuptoj, nga pikëpamja e teknikës ju jeni specialist dhe shumë mirë që ju kemi të tillë në këtë pikë. Unë dua të di, si qytetare e zakonshme, pa lidhjen shpirtërore apo monetare që keni me televizionin, si ju duket programacioni i RTSH-së? A ka nevojë për përmirësim?

Genc Tomço – Si qytetar, e shikoj se duhet të ketë përmirësim. Përmirësimet vijnë shumë ngadalë, por ka shumë për të bërë aty. Sipas synimit tim, gjëja e parë që do të bëj, është të shikoj a janë gjërat në vend apo jo të teknikës. Sipas eksperiencës sime, ajo është e përfunduar. Një gjë, unë gëzoj shëndet të mirë dhe u përgjigjem detyrave që më ngarkohen në Këshillin Drejtues. Do të keni relacione të sakta; është dhe një ko incidencë tjetër që ndoshta nuk e dini. Para disa vjetësh

Kuvendit iu dhurua një zinxhir audio-video. Me kërkesë të Kuvendit më thanë: “Si do t’ia bëjmë?”. E mora përsipër, e instalova, e vura në punë dhe e mirëmbajta për 7 vjet. Ishte kërkesë e Kuvendit, unë u përgjigja. Topi tani është te Kuvendi.

Flutura Aça – Ju faleminderit!

Po, zoti Koçi, ka një pyetje.

Petro Koçi – Kam një pyetje të shkurtër që kërkon një përgjigje po të shkurtër, sipas mendimit tënd, jo se do të ishte një përgjigje ligjore: kostoja e mirëmbajtjes së rrjeteve frekuencore është më e lartë sesa duhet, apo jo? Pra, 7 milionë e gjysmë që thoni ju.

Genc Tomço – Sistemi i shpërndarjes së sinjalit është një sistem i ndërlikuar, nuk është i lehtë, është shumë i manovrueshëm dhe elastik që mund të shfrytëzohet në shumë drejtime, me sa kam parë unë, po. Po të shikoj materialet, skemat e vërteta, do t’i saktësoj. Ajo që më bëri përshtypje, ishte kostoja e madhe. Ne, kur blejmë pajisjet, nuk kemi bërë asnjë kosto për mirëmbajtje. Kemi mirëmbajtur të gjitha pajisjet në mënyrë të shkëlqyer. Se si është bërë kjo punë, nuk mund ta them. Po, unë kam mundësi ta zhbiriloj këtë gjë për të mirën e punës, që ta çojmë përpara, të ngrihen njerëzit tanë dhe të shkurtohet sa më tepër fondi. Puna të bëhet nga specialistët tanë.

Flutura Aça – Zoti Tomço, faleminderit shumë!

Mund të vazhdoni.

Ju uroj sukses!

Do të shihemi!

Atëherë, kandidati tjetër zoti Ilir Goci.

Urdhëroni!

Mirë se erdhët!

Ju lutem, për efekt të regjistrimit, emri, mbiemri dhe një CV të shkurtër, pasi kolegët deputetë janë njohur me CV-në tuaj më të gjerë. Pas saj, çfarë ofroni ju, nëse do të zgjidheni në Këshillin Drejtues të RTSH-së? Çfarë do të përmirësoni, cila është qasja juaj?

Ilir Goci – Jam Ilir Goci. Kam mbaruar Fakultetin Ekonomik, dega Financë. Kam nisur karrierën në punë, duke filluar nga një llogaritar i thjeshtë, kryetar i degës së financës, nëndrejtor i INSIG-ut Tiranë, drejtor i Sigurimeve Shoqërore, drejtor kabineti në OST, nëndrejtor i Përgjithshëm në OST. Në mes të kësaj kam punuar, kam qenë edhe 4 vite e pak drejtor dhe

nëndrejtor i televizionit privat ATN 1. Arsyen pse jam këtu do ta përmbledh shumë shkurt dhe nuk besoj se do të ketë pyetje tjetër.

Së pari, lexova kriteret dhe binda veten se i plotësoj, kjo është kryesorja; e dyta, kam qenë sy i vëmendshëm, për hir të së vërtetës, dhe kam konstatuar që një institucion kaq i rëndësishëm si RTSH-ja të ketë një këshill administrativ, për arsye të profesionit të tyre, me gazetarë, me analistë, me piktorë, nuk ka asnjë ekonomist, që së paku një herë në muaj duhet të analizojë të ardhurat dhe shpenzimet, pa llogaritur bilancet vjetore. Pra, pyetja retorike është: a mund të drejtohet pa një ekonomist Këshilli Drejtues?

Këto janë dy arsyet e mia.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Goci!

A kanë pyetje kolegët deputetë?

Në fakt, të paktën në 10 vjetët e fundit kam parë që te hyrja e parkimit të televizionit ka qenë një gropë e madhe dhe ajo gropë nuk u mbush kurrë, megjithëse ju e dini se çfarë thesi të madh ka Televizioni shqiptar. Çështja është si mund të ndikoni ju konkretisht që financat e RTSH-së të jenë pak më transparente?

Illir Goci –Të kisha një bilanc përpara ose një plan financiar të RTSH-së, do t’jua kisha dhënë përgjigjen të saktë.

Flutura Açka – Po, zonja Buxheli.

Lindita Buxheli – Duke qenë vetë financiere, unë ju inkurajoj, por ju hyni atje edhe si financier, duke mbuluar edhe pjesën e televizionit? Domethënë, mendoni t’i bëni të dyja, se duke qëndruar vetëm në pozicionin e financierit mendoj që do ta lini bosh pjesën tjetër?

Illir Goci – Më duket se nuk jeni e qartë për rolin e anëtarit të Këshillit Drejtues, nga mënyra si e shtruat pyetjen. Unë nuk po shkoj të punoj atje si financier, as si shef llogarie dhe as si drejtor i departamentit të financave apo të ekonomisë, unë do të jem atje si anëtar i këshillit administrativ të RTSH-së dhe ky këshill është organ vendimmarrës, duke filluar nga drejtori dhe gjithë të tjerët.

Lindita Buxheli – Unë fillimisht ju inkurajova, por pyeta: a do t’i bëni të dyja, domethënë a e keni të plotësuar këtë pjesën e televizionit? Pra, ju pyeta se isha e paqartë se sa e keni ushtruar këtë pjesë të televizionit.

Flutura Açka – Faleminderit dhe suksese!

Atëherë kandidati tjetër, zoti Birbo.

Ju lutem, na prezantoheni fare shkurt me CV-në tuaj, si dhe qasjen tuaj për të përmirësuar RTSH-në, nëse do të zgjidheni anëtar i Këshillit Drejtues të tij.

Sa më shkurt, ju lutem!

Faleminderit!

Kristaq Birbo – Unë kam qenë ushtarak, ku kam kryer detyra të ndryshme deri këshilltar i Presidentit Moisiu, kam bërë kualifikime shumë të larta jashtë shtetit, midis tyre edhe në fushën e medias në Romë dhe Paris.

Për sa i përket risisë që mund të sjell në RTSH, kontributi im do të jetë natyrisht në fushën time, ku kam përmirësuar ndjeshëm mënyrën e transmetimit, duke e njohur publikun me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë në vend, të institucioneve ndërkombëtare të sigurisë, marrëdhënieve civile ushtarake, që, për mendimin tim, deri sot çalojnë.

Ky do të jetë kryesisht theksi i punës sime atje.

Flutura Açka – Faleminderit, zoti Birbo!

Problemi është që ushtrinë në 30 vjetët e fundit e keni bërë shoshë, megjithatë qasja juaj është interesante.

Kolegë, nëse keni pyetje, shtypni butonin që të keni mundësi të pyesni.

Zoti Koçi, keni fjalën.

Petro Koçi – Sigurisht, edukimi i publikut me çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes është i rëndësishëm dhe ka gjëra që ndoshta duhet të fillojnë që në vitet e para të arsimimit, sepse vetë koha po tregon që ky mbetet një prioritet, madje në rastin e emergjencave sërish ka nevojë për më shumë edukim. Ju e keni lexuar ligjin për sa u përket funksioneve që ka Këshilli Drejtues i RTSH-së, ndaj çfarë kontributi mendoni të jepni, përtej interesit që lidhet me aspektin e formimit tuaj profesional? Problemi është te funksionimi i televizionit, çfarë mendoni ju se duhet rregulluar në raportet e Këshillit me televizionin si ekzekutiv?

Kristaq Birbo - ... dhe që flet për çështjet administrative, për çështjet e programimeve, për rolin që luan Këshilli Drejtues. Ndërsa për sa i përket punës sime atje, natyrisht që kjo është diçka e re. Punët atje bëhen në ekip. Puna e parë është të njihesh me të gjitha hollësitë, problematikat, do të shohësh edhe vendin, natyrisht çdo gjë atje do të jetë në ekip, do të ketë propozime, diskutime, koordinim me njëri-tjetrin. edhe çështjet që mund t'i mbuloj, edhe ato do të bëhen në ekip, do t'i bindësh të tjerët. Nuk mund të çash vetëm nëse nuk bind edhe ekipin.

Flutura Açka – Faleminderit!

A ka ndonjë koleg tjetër?

Një nga gjërat e para që do të bëni është të bëni një program për ushtrinë, se na kërkon buxhet dhe ne e kemi të vështirë të merremi me këtë gjë!

Kristaq Birbo – Jo, absolutisht.

Flutura Açka – Gjithsesi, faleminderit shumë!

Suksese!

Kandidatja tjetër është zonja Rama.

Mirë se erdhët, zonja Rama!

Na vjen mirë që më në fund shohim një zonjë këtu! Këtu nuk ka diskriminim pozitiv, se ndryshe do të ishin zgjedhur si duhet.

Fjala është për ju.

Fillimisht na bëni një prezantim të shkurtër të CV-së suaj, pastaj na thoni çfarë do t'i ofroni ju RTSH-së, nëse do të zgjidheni anëtare, pra qasjen tuaj.

Faleminderit!

Majlinda Rama – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për fjalën!

Po bëj një prezantim të pjesshëm të CV-së sime për pjesën që i përket medias, duke qenë se për këtë vend konkurroj.

Kam një karrierë 20-vjeçare në fushën e medias, pas përfundimit të studimeve, kam pasur fatin dhe detyrimin, po e quaj, të jem gazetare.

Fillimet e mia i takojnë gazetarisë së terrenit, që është dhe një shkollë më vete për gazetarët, por më pas kam drejtuar një televizion privat për rreth 10 vjet, kam drejtuar programacionin dhe informacionin, pastaj kam dhënë kontribut në disa media të shkruara nga viti 2006 dhe aktualisht vijoj në gazetën “Panorama”.

Duke pasur një përvojë mediatike relativisht të gjatë, besoj se mund të jap kontributin tim si anëtare e Këshillit Drejtues të RTSH-së për arsye se e njoh mirë çfarë do të thotë sukses i një televizioni. Të gjithë ata që kanë punuar në media e dinë fare mirë që të funksionojë një televizion, patjetër duhet të ecin dhe funksionojnë paralelisht tri shtyllat kryesore: programacioni, informacioni dhe marketingu, të cilat besoj se i njoh mirë, më pak këtë të fundit, por dy fushat e para i njoh mirë dhe këtë e them me krenari dhe siguri.

Një pjesë juaja këtu më njohin si gazetare, veç të tjerash.

Nëse duhet të ndalem pak te RTSH-ja, pa ju lodhur, do të thosha që kam parë një Radiotelevizion publik që, sipas këndvështrimit tim, nuk përmbush disa kriteret për t'u shkëputur dhe për të luajtur rolin që i takon në pjesën publike të shoqërisë, për të pasur një mision gjithëpërfshirës, për t'i shërbyer edukimit, si dhe për të sjellë një format të ndryshëm nga televizionet private. Duke qenë se mungon kjo lloj konkurrence, kam menduar, ashtu sikurse dhe ju, që ka nevojë për disa ndërhyrje. Kuptohet që një zë nuk është asgjë, por besoj se, nëse bëhemi shumë zëra, mund ta transformojmë televizionin publik.

Të gjithë e dimë që ky televizion ka pasur kulmet e veta, të cilat sot duket sikur kanë ngelur pezull, sepse mungon konkurrenca e mirë, mungojnë garat, formatet televizive, të cilat çojnë përpara zhvillimin, mungon edukimi përmes kulturës, që është shumë i rëndësishme, sidomos për të rinjtë. Nuk ka atë që ne e quajmë formë joshjeje për të rinjtë. Për shembull, jo më larg se dy javë më parë pyeta studentët e mi nëse e ndiqnin televizionin publik dhe askush nuk kishte dijeni që ekzistonte Televizioni Publik Shqiptar, madje nuk e kishin kthyer asnjëherë kanalën në jetën e tyre.

Sipas meje, nuk dua të jem kundërshtuese, duhet ta shohin të vërtetë në sy, se kështu të gjithë mund të bëjmë një ndryshim. Mendoj se duhet të ketë hapësira për të gjitha moshat, mungon njeriu i ditës, njeriu i thjeshtë, mungon studenti, mungon i riu, mungojnë formatet argëtuese, spektaklet e përjavshme, mungojnë hapësirat, ku secili të gjejë veten. Pra, periferia kërkon të gjejë periferinë, qendra kërkon të gjejë qendrën, i varfri kërkon të gjejë mundësi për t'u bërë optimist.

Personalisht, mbase ju ndani mendime të tjera, shoh që këto nuk janë në nivelin e duhur. Pa diskutim janë bërë reforma, që duhen përshëndetur, por konsideroj që reforma më e madhe duhet bërë duke filluar ndryshe.

E para, duhen mbledhur ta gjithë kuadrot dhe personalitetet, të cilët dikur i kanë dhënë një emër RTSH-së, që sot, për fatin e tyre të mirë, japin kontribut në mediat private, por për fatin e keq të RTSH-së janë larguar prej aty, duke e kthyer gati në një ngrehinë të braktisur. Besoj se cilësinë e një ekranit e ngrenë profesionistët dhe nuk është e nevojshme të marrësh të drejtën e 14 kanaleve të RTSH-së dhe sërish të jesh nën sfidën e braktisjes nga audiencën, por mund të mbash më pak dhe të krijosh grintë dhe të tërheqësh audiencën, dhe besoj se RTSH-ja është në këtë betejë të ashpër, sepse ka humbur audiencën, pra është bërë një ekran gri, që duke e parë nga ana grafike ngjall një lloj trishtimi, por kjo është çështje tjetër.

Unë po jap këndvështrimin tim, nuk konsideroj se do të ndryshojë RTSH-ja nga kjo, por duke qenë se ka fituar të drejtën e 14 kanaleve, është mirë të investohet në to dhe jo të bëhet sikur,

t'u hyhet problemeve në thelb, pra çështjet të analizohen dhe të bëhen një zë i fuqishëm. Nuk mjafton të bëhesh mikrofon transmetues, sepse deri tani kështu është bërë, madje po të hapnim tani tre kanalet e RTSH-së, TV Korça dhe dy të Tiranës japin të njëjtat gjëra, përsërisin dhe kjo është humbje e vlerave. Unë kam qenë e ftuar në RTSH disa herë, edhe në Radio dhe kam parë që ka ndryshuar për mirë, dhe është për t'u përgëzuar investimi në teknologji, gjë që është një nismë shumë e mirë, por nuk është gjithçka.

Unë kam parasysh fillimet e mia në gazetari në vitet 2000, pas përfundimit të studimeve, kur nuk kishim investime të mjaftueshme, por kishim shpirtin, pasionin e pafund dhe dashurinë për profesionin, që sot janë zbehur, sepse gazetarët priren më shumë nga përfitimet monetare dhe është për të ardhur keq që dhe të vjetrit kërkojnë të fitojnë më shumë. Të rinjtë janë mësuar me moton “të fitojmë sa të mundim”. Ky është një handicap i madh në media, se media nuk është një fabrikë tullash, që po nuk u bë puna sot, punë e madhe, se bëhet nesër dhe po thamë “Po të paguani, ne do të bëjmë sikur punojmë dhe do t'ia dalim”, media nuk ta fal gabimin më të vogël, sepse kërkon dinamikë, kërkon patjetër një sistem supersonik, kërkon transmetime *live*, kërkon gjallëri, nuk kërkon ato emisionet që, të paktën nga përvoja ime në RTSH, regjistrohen sot dhe jepen pas tre muajsh. Ai televizion është i vdekur, më kuptoni çfarë dua të them? Ai qytetar i mençur, ose jo arrin ta absorbojë dhe ta kuptojë se kur dhe si transmetohen emocionet. Që një televizion ta përmbushë këtë pjesë, duhet patjetër të shfaqë emocione, por emocionin ka vdekur.

Mund të më bëni dhe pyetje.

Flutura Açka – Po, zoti Ndreca.

Eduard Ndreca – Faleminderit, zonja kryetare!

Zonja Rama dhe të gjithë ju që keni ardhur sot këtu, por sidomos zonja Rama e tha pak më ashpër, thatë që RTSH-ja është e vdekur.

Pse kërkonin të shkoni mes të vdekurve, zonja Rama?! A do ta keni forcën ta ngjallni?! Mendoni se nuk ka bërë asgjë RTSH-ja në këto vite, që mbetet tashmë te këta dy anëtarët e rinj që do të shkojnë ta rivitalizojnë?! Nga gjuha që ju përdorni, nëse unë do ta shihja kështu një institucion, as që do të merrja mundimin t'i afrohesha, jo më të konkuroja për një pozicion pune atje. Tendencë për ta zbehur atë institucion me besimin se rrit peshën tuaj apo gatishmërinë tonë për të vlerësuar atë që ju do të bëni, nuk më duket rruga e drejtë.

Flutura Açka – Zoti Ndreca, faleminderit!

Zonja Rama, fjala për ju.

Majlinda Rama – Faleminderit për pyetjen!

E dija që dikush nga ju do ta bënte këtë pyetje dhe bëtë shumë mirë.

E para, unë jam shkrimtare në profesion dhe të thuash një ekran i vdekur, është krejtësisht përcaktim metaforik. Besoj se ju e kuptoni këtë. Nuk dua të sjell insinuata të tilla, që ta denigroj atë që është bërë, absolutisht, sepse unë jam një e re, si shumë të rinj të tjerë, që kërkoj të bëjnë një gjë. Pak më parë thatë që kërkoj të shkoj në një institucion të mbyllur, të vdekur. Unë besoj që të gjithë ne duhet të japim kontribut atje ku ka nevojë, se një ent tjetër, që funksionon shumë mirë, ma do mendja që nuk ka nevojë për asnjërin nga ne.

E thashë këtë, mbase e bëra parantezë, edhe për të hapur pak debat, nëse duhet. Nuk e di, por po ju drejtohem me një pyetje. Sa herë e shihni ju RTSH-në dhe çfarë shikoni? Cili është programi që keni ndjekur më shumë?

Flutura Açka – Në fakt, pyetjet i bëjnë deputetët këtu.

Eduard Ndreca – Nuk ka problem. Të them të drejtën e kam parë, por në zonën ku jam rritur, në një pjesë të Mirditës, vetëm TVSH-në kapte dhe kam pasur kënaqësinë ta shoh për shumë vite, por këto vitet e fundit nuk e kam parë shumë shpesh. Pas përzgjedhjes së dy kandidatëve këtu dhe pasi në TVSH të vijë Mesia, unë do ta rishoh RTSH-në.

Flutura Açka – Faleminderit!

Do të bëj vetëm një ndërhyrje të vogël, duke qenë e së njëjtës fushë, jo se është e vetmja femër, se nuk më pëlqejnë këto lloj ndarjesh, por kam një obligim para komisionit që të shpjegoj se zonja Rama është një zonjë shumë dinjitoze në letrat shqipe. Ka shumë rëndësi ta them këtë gjë, e cila e vetme, ndryshe nga shumë kolege të tjera, ka punuar atje në bazë, kurse ne kemi nxituar të konkurrojmë në qendër për të rënë në sy. Ajo i ka dhënë Fierit gjallëri për vite të tëra, ndaj unë e përgëzoj publikisht, se më parë nuk ka qenë rasti. Këtë e them se kjo vajzë nuk e ka ambicien se ka nevojë të duket, por se ka nevojë të bëjë punë. Këtë e kam shumë të qartë.

Kjo nuk ka të bëjë fare për të ndikuar në komision për emërimin e saj, por doja ta thosha, se dua të jem e sinqertë në gjërat që them.

Faleminderit!

Eduard Ndreca – Në fakt, unë nuk e kisha vetëm me zonjën, për të cilën kam shumë konsideratë, sepse ia lexova CV-në, por zonja na frymëzoi më shumë, dëgjuam edhe kandidatët e tjerë dhe erdhi koha për pyetje. Kështu që, nuk e kisha në plan personal pyetjen që bëra, por nga konkurenti i parë deri te ju ishte e njëjta qasje ndaj RTSH-së.

Mendoj se RTSH-ja nuk është në atë ditë zie sa e paraqitën të gjithë kandidatët.

Flutura Aça – Faleminderit, zoti Ndreca!

Zoti Ajazi, pastaj zoti Spaho.

Besion Ajazi – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë ashtu si ju, doja ta vlerësoja karrierën e zonjës Rama sa u përket letrave shqipe, por jemi mbledhur për kandidaturat për Këshillin Drejtues të RTSH-së dhe jo për shtëpinë botuese. Gjithsesi përgëzime për karrierën në prodhimtari në letërsi dhe në zhanëra të tjerë!

Kam një pyetje konkrete dhe direkte: a mendoni se mjafton karriera juaj si gazetare e terrenit dhe si drejtuese e një medie private lokale për të qenë një nga anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së? Nënpyetja është: a e njihni ju lidhjen ndërmjet Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH-së, pra a i njihni kompetencat e anëtarit të Këshillit Drejtues? Kryetarja pyeti të gjithë kandidatët në fillim të prezantimit që çfarë do të sillni ju në Këshillin Drejtues, por a i njihni kompetencat, a mendoni se keni fuqi t'i realizoni ato ndryshime që mendoni dhe që i paraqitët komisionit?

Faleminderit!

Majlinda Rama – Faleminderit për pyetjet!

Mos shkela protokollin? Ju kërkoi ndjesë!

Edhe unë pak më parë thashë që do të bëj një prezantim të pjesshëm të CV-së, pra atë pjesë që lidhet me medien, se për pjesën e letërsisë e kam marrë *feedback*-un pozitiv. Kështu që, nuk po prezantoj atë pjesë dhe e falënderoj Fluturën për prezantimin që më bëri. Ne këtu po flasim për medien dhe ju pyetët nëse unë i kam mundësitë e mia intelektuale për të bërë një ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I rikthehem edhe një herë karrierës në media, zoti Ajazi, unë nuk do ta ndaja pjesën lokale nga ajo qendrore, sepse të gjithë jemi lokalistë. Gjatë periudhës që kam dhënë kontribut në media, kam drejtuar edhe disa emisione dhe debate politike, tema sociale për të arritur deri te kultura, që është fusha ime. Besoj se një zë i vetëm patjetër që nuk bën gjë, e thashë pak më parë, prandaj të bëhem disa zëra dhe të themi atë që është. Filozofia e punës sime nuk është që të bëj ca qoka, të zë ca miq për të ecur, sepse çfarë mendoj e them. Mundet që dikujt të mos i vijë mirë, por ky është mendimi im, se me pyetët çfarë mendimi kam.

Kështu që, nuk kam dëshirë të dal nga kjo derë me rezerva, as dua t'ju ndikoj, por nëse më jepni mundësinë të bëhem pjesë e këtij këshilli, pa diskutim që do të jap ndihmën time për të rritur

cilësinë, se unë nuk mund të hyj në çështje të administrimit të brendshëm, por mund të jem një zë dhe të llojoj bashkë me kolegët e mi të Këshillit, një pjesë të madhe të të cilëve i kam miq dhe bashkëpunoj me ta.

Unë mendoj se të gjithë bashkë mund të bëjmë diçka dhe ju, po aq sa unë, nuk është nevoja ta ndajmë në politikë, se kjo më lëndon gjithë jetën. Ndarja dhe politizimi i një ekрани është një minus i madh për ekranin dhe nuk duhet ta shohim në këtë këndvështrim, të majtë dhe të djathtë, ekрани është një dhe sa më larg të qëndroni ju apo shumë miq të mi të politikës, aq më mirë mund të funksionojë, sepse dëmtohet çdo ditë duke futur njëri mikun e tjetri shokun.

Televizioni nuk ka drejtor, ka drejtorin e madh të RTSH-së dhe sipas meje televizioni publik ka nevojë të ketë një drejtor, që ta menaxhonte përditë, sepse e thashë pak më parë që televizioni është konsum i përditshëm dhe kërkon dinamikë. Këto janë gjëra që nuk zgjidhen sot, nesër, pasnesër, apo për një javë, se televizioni nuk pret, sepse është i shpejtë. Në këtë këndvështrim mund të jap kontributin tim. Ju mos mendoni që unë do të shkoj atje me fuqinë e shkopit magjik, se ky do të ishte një mendim prej Don Kishoti.

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Rama!

Një shtesë të fundit, para se të kalojmë te kandidati tjetër.

Besion Ajazi – Nëse gjithë kjo gjë do të varej nga vota ime, patjetër që do të ishte për ju dhe vetëm për një gjë: unë jam ish-gazetar terreni vetë dhe do të doja që në atë Këshill Drejtues të ishte një ish-gazetar ose një gazetar aktiv, por kjo kërkon patjetër vendimmartjen e komisionit.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Rama!

Suksese dhe do të mbetemi në kontakt!

Majlinda Rama – Faleminderit dhe juve!

Punë të mbarë!

Flutura Açka – Ju lutem, të vijë kandidati tjetër!

Zoti Çapaliku, mirë se erdhët!

Urdhëroni, ju lutem!

Një pjesë jona ju njeh, por për efekt regjistrimi thoni emër, mbiemër dhe një prezantim të shkurtër të CV-së, pasi kolegët e kanë lexuar tashmë, si dhe çfarë ndryshimi do të ofroni ju nëse do të zgjidheni anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Stefan Çapaliku – Unë jam Stefan Çapaliku, lindur më 1965 dhe kam goxha kohë në këtë vend. Kam studiuar për gjuhë-letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës, më pas studimet e mia i kam fokusuar kryesisht në fushën e estetikës në Universitetin e Pragës, më vonë edhe në vende të tjera europiane, si: Angli, Itali apo në disa qendra të tjera të rëndësishme të studimeve estetike.

Karriera ime është e lidhur më së shumti me universitetin, kam qenë për vite të tëra lektor, ligjërues në universitetin e Shkodrës deri në vitin 1998, pastaj në Akademinë e Arteve, në Fakultetin e Dramës nga viti 1998 deri 2015 dhe prej vitit 2015 jam *full time* kërkues në Akademinë e Studimeve Albanologjike Shqiptare, në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë, ku mbuloj Sektorin e Studimeve Historiko-Letrare, pra merrem me studime letrare të letërsisë shqipe.

Që prej vitit të kaluar jam zgjedhur anëtar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë në pozicionin e studiuesit letrar dhe të shkrimtarit.

Kjo ka qenë karriera akademike, të cilën në mënyrë paralele dhe intensive e kam shoqëruar me aktivitetin tim krijues, që ndahet në dy blloqe kryesore: blloku i parë ka lidhje me dramaturgjinë, me teatrin, ku për shumë vite kam qenë një prej autorëve më aktivë në skenën e teatrit shqiptar, duke mbajtur gjallë flakën e dramaturgjisë kombëtare shqiptare, njëkohësisht jam marrë edhe me krijimtari tjetër, me prozën.

Nuk mund të mos e përmend edhe një aktivitet të rëndësishëm për mua personalisht, por besoj edhe për komunitetin, si regjisor teatri, por edhe si regjisor i filmit dokumentar apo specifikisht ajo që quhet *mockumentary*, pra *docufiction*.

Këto janë në linja të përgjithshme disa shtylla të aktivitetit tim. Vepra është bërë e njohur jo vetëm brenda territorit të Shqipërisë, por edhe jashtë, është përkthyer në disa gjuhë të huaja. Jam pjesëmarrës në disa evente të rëndësishme ndërkombëtare, i nderuar edhe me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Kështu që besoj se eksperiencia e grumbulluar në mënyrë sistematike dhe pa pasur pauza të rëndësishme në karrierën time, më ka bërë të mendoj se mund të jetë e vlefshme edhe në fushën e ndërtimit të disa orientimeve, të disa politikave kulturore, që në rastin konkret kanë të bëjnë dhe me Televizionin Publik Shqiptar.

Kjo ishte një paraqitje e shkurtër. Nëse dikush do të dijë diçka më tepër rreth meje, jam këtu për ju.

Flutura Aça – Faleminderit, zoti Çapaliku!

Zonja Zhupa ka pyetje për ju.

Ina Zhupa – Në fakt, më shumë se pyetje, kisha dhe një koment.

Duke e vlerësuar figurën dhe kandidaturën tuaj shumë serioze për këtë pozicion, për të gjithë kontributin që i keni dhënë dhe vazhdoni t’i jepni fushës sonë artistike letrare dhe si anëtar i Akademisë së Shkencave, është në nderin e këtij komisioni që ka përballë një individ si ju edhe për ta intervistuar, edhe për të dhënë kontribut në institucionet shqiptare!

Meqë duhet të ndjekim traditën e pyetjeve, do t’ju drejtoj edhe një pyetje, për t’ju marrë edhe një lloj mendimi.

Radiotelevizioni Shqiptar ka qenë edhe pika e referencës për sa i përket transmetimit të filmave shqiptarë, të prodhimit të asaj që është kinematografia shqiptare. A e keni në planet tuaja nesër, si anëtar i Këshillit të Radiotelevizionit Shqiptar, që duhet bërë më shumë?

Çfarë mund të bëhet më shumë në këtë drejtim, për të kthyer lavdinë që kishte edhe në prodhimtarinë e filmit?

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Zhupa!

Po, zoti Çapaliku.

Stefan Çapaliku – Duhet t’i mbledh të gjitha pyetjet apo duhet t’u përgjigjem një nga një?

Flutura Açka – Duhet t’i përgjigjeni çdo pyetjeje.

Faleminderit!

Stefan Çapaliku – Më fal, por në prezantimin e shkurtër harrova t’i përgjigjem pyetjes suaj të dytë, pra çfarë më ka sjellë mua këtu dhe do të doja ta thosha me dy fjalë, për të kaluar te përgjigjja e zonjës së nderuar!

Mendoj se problemi kryesor i publikës në Shqipëri është se sa shkojnë kontributet publike në ruajtjen e identitetit nacional. Jetojmë në një vend, në një epokë, ku globalja, globalizimi është në një revansh të jashtëzakonshëm dhe viktima të këtij revanshi, më së pari, do të jenë vendet e varfra, vendet e vogla, vendet të ashtuquajtura kultura minore. Në këtë kuptim, duhet të marrim masa urgjente, sa më të rrepta të jetë e mundur, sa më profesionale të jetë e mundur, në mënyrë që të rigjenerojmë edhe një herë atë që po na humb çdo ditë, që po na rreshkët nga këmbët çdo ditë, që është identiteti ynë nacional. Kjo është filozofia ime, të cilën do të doja ta mbroja me çdo kusht, jo vetëm nëse nesër zgjidhem anëtar i këtij bordi, por në çdo dalje timen publike.

Tani po i kthehem përgjigjes së pyetjes suaj. Mund t’ju them se pikëpamja ime është kjo, që historinë nuk mund ta zhbëjmë. Historia është ajo që është. Historinë duhet vetëm ta

konservojme. Është pak a shumë si ajo që ka ndodhur në Shkodër para disa vitesh. Në kalanë e Shkodrës ne kemi një kishë, që quhet kisha e Shën Shtjefnit, e cila më vonë është shndërruar në një xhami. Aty plasi një konflikt i madh, sepse kisha, nëpërmjet një fondi të marrë nga të huajt, kërkonte ta kthente edhe një herë në kishë dhe komuniteti mysliman nuk e dëshironte këtë. Në një prej daljeve të mia në publik kam mbrojtur këtë ide, që ajo duhet të ruhet kështu siç është, siç na e ka lënë koha. Ne nuk mundemi dot të bëhemi gjykatës të së shkuarës. Ne duhet ta ruajmë të shkuarën dhe t'u tregojmë brezave që kjo ka qenë në fillim kishë, mandej ne patëm një moment invazioni prej perandorisë turke dhe ata e bënë xhami e më vonë shkrepri një rrufe, që e dogji dhe e ka lënë kështu siç e ka lënë. Pra, historia mund të tregohet ndershem me tri fjalë. Kjo është pikëpamja ime në lidhje me filmat apo me çdo gjë që na vjen nga e shkuara.

Flutura Ačka – Faleminderit, zoti Çapaliku!

Fjalën e ka zoti Boçi dhe më pas zoti Koçi.

Luçiano Boçi – Kënaqësi për kandidimin tuaj, zoti Çapaliku!

Ju njiheni si njeri i librit, si krijues i librit dhe si vlerësues i tij. Shqetësimi im kryesor është që televizioni është larguar nga libri, shoqëria është larguar nga libri dhe, duke humbur librin, po humbasim edhe brezat dhe edukimin. Kemi humbur sidomos librin artistik.

Në Radiotelevizionin Shqiptar ka një emision, në fakt, që unë e konsideroj ndër më të mirët dhe më të dëgjueshmin në raport me vlerat e librit dhe vlerat artistike, por nuk e quaj të mjaftueshëm, sepse vërtet do të na duhet më shumë investim përderisa jemi përpara një televizioni publik.

Ju, duke u bërë anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit, si do ta stimuloni promovimin e vlerave të librit në shoqërinë shqiptare, nëpërmjet këtij televizioni? Unë e quaj domosdoshmëri këtë.

Vetëm këtë pyetje kisha.

Faleminderit!

Stefan Çapaliku – Faleminderit, profesor!

Para se të vij këtu, sigurisht që jam përpjekur të lexoj sa më shumë që kam mundur për konceptet, për atë çfarë është shkruar për televizionin publik dhe kam kuptuar se e gjithë përpjekja reformuese qëndron në tri pika, i kam gjetur të shkruara: informim, edukim dhe argëtim, por nuk kam gjetur një pikë të katërt, që është formimi. Pra, është ndryshe të jesh i informuar dhe ndryshe të jesh i formuar. Informacionin ne e marrim prej këtij këtu më së shumti, por për formimin ka

vetëm një rrugë, që është libri. Nuk ka asnjë gjë tjetër, nuk ka asnjë medium tjetër. Pra, deri më sot nuk ekziston një medium i tretë, që të plotësojë atë që ne e quajmë formim. Në këtë kuptim, edhe bibliotekat janë magazinat e dijes, jo të informacionit. Pra, nuk mund të themi që jam përdorues i një biblioteke se shkoj për të lexuar gazetën. Ti je përdorues i një biblioteke, sepse shkon për të lexuar libra, për të marrë libra, për të shkëmbyer libra apo medime të tjera të krahasueshme me librin. Në këtë kuptim, libri është esencialisht i lidhur me identitetin nacional, që jua thashë në krye të herës, dhe me shqipen, me gjuhën tonë të dashur. Në vëzhgimet e mia josistematike, me aq sa kam mundur ta ndjek Televizionin Publik Shqiptar, kam vënë re se aty ka njerëz të cilët kanë një fjalor të mjerueshëm. Pra, ti mund të marrësh emisionin e lajmeve dhe të monitorosh leksikun se sa fjalë ka përdorur spikerja. Spikerja ka përdorur 120 fjalë për të bërë një emision lajmesh! Ky është një tmerr! Pra, nuk mundet të kemi një kontaminim, një ndotje të ambientit, të mjedisit kulturor më të madh sesa kaq, të shkatërrojme shqipen, ndërkohë që një institucion i mbajtur me taksat tona, pra një institucion publik do ta kishte detyrë themelore promovimin e shqipes, të dialekteve të saj, të nëndialekteve të saj, të të folmeve të të gjitha diversiteteve, që për fat gjuha jonë e dashur i ka. Kështu që, pa dyshim, do të doja ta vija diku në krye të diskutimeve këtë problem, por kam për të shtuar edhe diçka, që do ta doja ta ndaja me ju.

Në vitin 2004 jam gjendur në parlamentin rumun, asokohe punoja në Ministrinë e Kulturës dhe mbuloja drejtorinë e librit, ku po diskutohej në një seancë dëgjimore ligji për librin. Në të njëjtën ditë kur po diskutohej ligji për librin, diskutohej edhe ligji për median. Nuk e di nëse funksionon më, nëse e kanë amenduar apo jo këtë ligj, por ata kishin ndërtuar një situatë të tillë, ku lajmet që do të transmetonte televizioni publik rumun duhet të ishin gjysma pozitive dhe gjysma negative. Se ku do t'i gjenin lajmet pozitive, e dinin ata. Lajm pozitiv është edhe promovimi i një libri; lajm pozitiv është dhe dalja në një konferencë e një shkrimtari apo e një artisti, e një ekspozite e të tjera. Ne nuk mundemi dot ta shkatërrojme audiencën tonë, duke dhënë vetëm krime këtu, aksidente atje, vrasje këtu e të tjera. Pra, kjo politikë e mbrojtjes së identitetit tonë të shkojë deri tek informacioni, deri te shtylla e parë e këtij mediumi, që quhet televizion publik.

Flutura Aça – Faleminderit!

Fjala për zotin Koçi.

Petro Koçi – Zoti Çapaliku, mirë se erdhët në komision!

Është i padyshimtë personaliteti juaj artistik dhe është në nderin e këtij komisioni që dëgjon një figurë si ju, që kandidon për të qenë pjesë e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar!

Në fakt, ne jemi një komision që jemi përballë një halli të madh, sepse përveç jush ka edhe disa figura të tjera, që ne i dëgjuam sot. Për të thënë të drejtën, do të jemi në vështirësi, sepse këtu përzgjedhja bëhet nëpërmjet skualifikimit, gjë që moralisht do të na vendosë në vështirësi me shumë persona, që edhe i njohim personalisht.

Dua të vlerësoj këndvështrimin tuaj, jo vetëm karrierën tuaj qoftë artistike, qoftë akademike, sidomos këndvështrimin lidhur me rolin që mund të luani në Këshillin e Radiotelevizionit Shqiptar. Vlerësova sidomos merakun për gjuhën shqipe dhe i bashkohem shqetësimit tuaj, që ne jemi duke e bastarduar gjuhën. Edhe nëpër televizione shohim gabime të rënda ortografike. Shqipja është gjithnjë e më shumë duke u ngrënë. Në njëfarë mënyre, kjo lidhet dhe me atë që thatë ju në fillim, që globalizimi rrezikon asimilimin e vendeve të vogla dhe të komuniteteve gjuhëfolëse, që janë më të vogla se të tjerat dhe ne duhet t'i rezistojmë kësaj.

Duke ardhur tek ajo që thatë në fund, tek ekuilibri i gjërave, në fakt, e kisha menduar si pyetje që në fillim dhe më vjen mirë që kemi të njëjtin këndvështrim edhe moral, etik apo dhe estetik, dua të më thoni me tri fjalë, tri gjëra që nuk shkojnë sot në Radiotelevizionin Shqiptar dhe tri gjëra që shkojnë mirë.

Faleminderit!

Stefan Çapaliku - Kjo është pyetje 6-milionëshe!

Po nisemi nga fakti që mendoj se Radiotelevizioni nuk ka një platformë që ne ta kuptojmë, pra që nga programacioni i saj të kuptojmë se ky programacion është ndërtuar me një platformë. Ose unë jam i paaftë ta kuptoj këtë, ose me të vërtetë nuk ekziston një lidhje midis programacionit të kësaj platforme të supozuar. Ky është problemi i parë gjeneral. Prej këtij devijojnë, rrjedhin edhe plot probleme të tjera, që mund t'i marrim me radhë dhe do të na dilnin shumë më tepër sesa tre.

Mendoj se ajo çfarë promovohet në përgjithësi në Televizionin Publik Shqiptar nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me filozofinë e mbrojtjes së identitetit. Pra, është ndryshe të promovosh pica dhe është ndryshe të promovosh një produkt tradicional shqiptar. Janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme. Do të thoni ju se ai që bën pica, jep paratë për reklamë, por ne e kemi televizion publik, nuk e kemi televizion privat, fati i të cilit matet nga reklamat.

A mundemi ne të kemi një televizion edhe pa reklama?

Unë di që çdo shqiptar pagan taksë për televizionin. Nuk e di në shifra absolute sa është ajo taksë, sa e mjaftueshme është ajo dhe sa i mjaftueshëm është buxheti që jep shteti, që një

televizion të jetojë edhe për reklama, por ama është më mirë të jepet 4 orë emision pa reklama picash sesa me reklama picash. Kjo nuk diskutohet!

Problemi tjetër ka lidhje me atë se çfarë përzgjidhet nga jashtë. Po marrim shembull kinemanë, filmat që transmetohen. Ne jemi të gjithë koshientë që çdo film ka një moral të vetin, pra transmeton një mesazh. Nuk mund të japim në Televizionin Publik Shqiptar filma me aksion. Çfarë do të thotë “filma me aksion”? Për kë është filmi me aksion, se si njëri vret tjetrin dhe del një hetues, që e gjen se kush e ka vrarë, dhe pastaj gjatë rrugës vret edhe 2 të tjerë. Nuk ka kuptim! Pra, këto janë 3 pikat e dobëta.

Ne na duhet të promovojmë, me aq sa kemi mundësi, kinemanë tonë. Televizioni shqiptar ka një traditë jo të keqe në produksionin filmik shqiptar. Kam parasysh në vitet '70 nisi eksperiencia me “Zekthin”, nëpërmjet Albert Mingës, si regjisor i parë, më vonë me Vladimir Priftin, me filmin “Udha e shkronjave” dhe filma të tjerë shumë të mirë televizivë, me “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur” dhe kështu me radhë. Aktualisht, ose e kemi zero numrin e produksioneve filmike, ose nëse nuk është zero, është i paidentifikueshëm, UFO, *Unidentified flying object*, nuk ekzistojnë. Jam duke folur vetëm për gjëra negative, nuk i kam gjetur akoma ato pozitivet, të më falni!

Flutura Aça – Faleminderit!

Zoti Ndreca ka një pyetje për ju.

Eduard Ndreca – Profesor, është kënaqësi që jeni sot këtu me ne!

Në fakt, unë jam i vonë në Universitetin e Shkodrës, por atje sot e kësaj dite gjen vlerësimin maksimal për emrin dhe punën tuaj, kështu që, besoj se nuk ka fjalë për të thënë.

Më ngeli pak në mendje çështja e varfërisë në fjalor, në fjalorin e lajmeve, të emisioneve të ndryshme e të tjera. Në fakt, unë e konsideroj problem më të vogël sesa barbarizmat në gjuhën shqipe. Këtë e konsideroj problem serioz, i cili, fatkeqësisht, nuk ngelet më vetëm në këto emisione dhe në diskutime, të mos diskutojmë parlamentin pastaj, sepse është bërë model. Për mua është mandati i parë, kam marrë një fletore në shtëpi dhe, për shembull, më fal, del Ina Zhupa, kolegia jonë, dhe unë mbaj shënim. Ka thënë këto fjalë të huaja, vendos fjalën shqipe në krah dhe do të vijë një ditë që të gjitha këto t'i lexoj aty, për të dhënë mesazhin që ne e kemi shumë të pasur gjuhën shqipe dhe e kemi mundësinë të flasim shqip.

Pra, e shoh shumë serioz këtë problemin e barbarizmave, që ka hyrë deri të libri. Libri është pasuria më e madhe, por ka hyrë deri aty dhe gjuhën shqipe në fakt po e vrasim edhe me librin. Ju i përmendët këto, por ideja është si mundemi t'i zgjidhim? Të gjithë i vëmë në dukje, të gjithë i

përmendim, ju, ne këtu, kudo ku jemi, por problemi është të tentojmë të vijmë me një zgjidhje. Unë vij me këtë zgjidhje, për shembull, jo me zgjidhjen magjike, por me një nisje për të shkuar drejt zgjidhjes më të mirë të mundshme. A keni ju ndonjë ide si mundemi ta zgjidhim këtë?

Faleminderit!

Stefan Çapaliku – Ne kemi pasur një traditë shumë të mirë të shtypit shqiptar gjatë kohës së komunizmit në relacion me gjuhën shqipe. Cila ka qenë kjo traditë? Po marrim një gazetë, gazetën “Bashkimi” të asaj kohe. Gazeta “Bashkimi” ka pasur një kryeredaktor, një kolegjiun redaksie, një redaksi, ka pasur redaktorët, ka pasur korrektorët dhe ka pasur një person që quhej “i freskëti”, nuk e di nëse e keni ndeshur ndonjëherë këtë term. Çfarë ishte “i freskëti”? Pasi kalonte gazeta në të gjitha këto hallka, pra lexohej nga kryeredaktori, lexohej nga gazetarët, nga redaktorët, ishte korrektuar nga korrektorët, bocat shkonin në orën 2:00 të mëngjesit të “i freskëti”. Detyra e “të freskëtit” ishte të ishte i freskët. Pra, të lexonte me përgjegjësi absolute dhe të mos linte asnjë gabim dhe vetëm pasi e firmoste “i freskëti” bocën, shkonte boca në shtypshkronjë dhe dilte të nesërmen në shtyp.

Ku qëndron problemi të kemi “të freskëtin” në departamentin e lajmeve të RTSH-së? Ne kemi aty rreth 2 mijë vetë, që nuk e di pse e marrin rrogën. “I freskëti” duhet të jetë në çdo redaksi, ai e merr fjalën e huaj, e hedh në kosh dhe vendos fjalën shqip, ta korrekton nga pikëpamja gjuhësore, morfologjike, fonetike, sintaksore, që është edhe më kryesorja. Kjo është zgjidhja. Ne kemi harruar nga kemi ardhur, ose jemi treguar agresivë, ose asgjë, ose të tëra. Kemi shumë gjëra për të sharë dhe shumë gjëra për të marrë dhe kjo është një prej gjërave që mund ta marrim.

Flutura Aça – Faleminderit, zoti Çapaliku!

Dikush tjetër ka ndonjë pyetje? Nuk ka.

Faleminderit, atëherë!

Suksese!

Stefan Çapaliku – Faleminderit juve!

Flutura Aça – Atëherë, kalojmë te kandidati i radhës, zoti Krenar Hajdëri, kandidati i fundit; thashë i radhës, se fjala “i fundit” nuk më pëlqen. Për shembull, për librat nuk them asnjëherë “libri im i fundit”, unë them “libri im i radhës”.

Zoti Hajdëri, faleminderit! Mirë se erdhët!

Për efekt regjistrimi, duhet të thoni emrin, mbiemrin, një CV-i sa më të shkurtër dhe çfarë ofroni për të qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Faleminderit!

Krenar Hajdëri – Faleminderit për mundësinë që më dhatë!

Quhem Krenar Hajdëri. Kam lindur në Tiranë në tetor të vitit 1957 dhe kam mbaruar shkollën e lartë pranë Universitetit shtetëror të Tiranës në vitin 1982 për Gjuhë dhe letërsi frënge. Menjëherë pas përfundimit të shkollës kam punuar si përkthyes pranë ish-shtëpisë botuese “8 Nëntori”, që ka qenë në atë periudhë në Shqipëri, në librin politik; më pas kam punuar në Ministrinë e Jashtme. Në vitin 1990 kam qenë diplomat pranë Ambasadës Shqiptare në Paris, për një periudhë 3-vjeçare. Më pas jam kthyer në Shqipëri dhe kam punuar në disa vende të ndryshme, mes të tjerash te Gjykata e Kasacionit, në periudhën 1995-1996 dhe më pas kam punuar në Kuvendin e Shqipërisë. Pra, duke filluar nga viti 1999, unë jam punonjës në Kuvendin e Shqipërisë, ku kam mbuluar detyra të ndryshme. Fillimisht, kam qenë drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë i Kuvendit të Shqipërisë, më vonë kam qenë këshilltar në Komisionin e Jashtëm të Kuvendit të Shqipërisë dhe që prej vitit 2016 e në vijim, pra aktualisht, jam drejtor i Shërbimit të Redaktorëve.

Veç kësaj, kam pasur edhe aktivitet të jashtëm: kam dhënë mësim në fakultete në Tiranë, kam dhënë mësim në degën e “Gazetarisë” për një vit radhazi, ku kam krijuar një lëndë të re për shkencat politike.

Harrova t’ju thosha më parë se kam mbaruar studime edhe në Francë, ku kam mbrojtur një diplomë të studimeve të thelluara, që quhet “*Diplôme d’études approfondies*” në vitet 1994-1996 në Paris, në Universitetin e Sorbonës.

Pra, kam dhënë mësim në degën e “Gazetarisë”, kam dhënë mësim në Fakultetin e Gjuhës Frënge dhe në universitetin “Luarasi”, për një periudhë kohore. Më vonë, për shkak të impenjimeve që kisha në Kuvend, e kisha thuajse të pamundur të vazhdoja më tej.

Krahas kësaj, kam pasur edhe një aktivitet, që ju ndoshta e keni parë në CV-i. Hobi im i madh, dashuria e parë ishte përkthimi, kështu që kam vazhduar me përkthime librash të letërsisë artistike të llojeve nga më të ndryshmet, por edhe politike në tërësi. Kam 40 libra të përkthyer nga gjuhët e huaja në shqip dhe përkthimet e mia janë kryesisht nga anglishtja, nga frëngjishtja, kam edhe nga spanjishtja dhe nga italishtja. Është një aktivitet, që kam dëshirë ta vazhdoj, sepse më është kthyer në një formë kënaqësie, në njëfarë mënyre.

Doja të thosha disa fjalë edhe për shkakun për të cilin jemi këtu. Kam paraqitur kandidaturën time për të qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar edhe përpara

1 viti, ku ishin krijuar disa vende vakante, gjë që nuk munda ta kapërcej dot për disa arsye, që ngelen në rrafshin personal, nga mënyra si u procedua në përzgjedhjen e kandidatave, gjë për të cilën shpreha edhe pakënaqësinë time pranë kryetarit të komisionit të asaj kohe dhe aktualisht, tani që u krijua kjo mundësi, nuk e di sa mund të jenë shanset. Gjithmonë njeriu në këto raste niset me një lloj difidence, me një lloj mosbesimi se diçka mund të bëhet, por, meqenëse i kisha dokumentet këtu, thashë do ta provoj edhe kësaj radhe.

Lidhur me Radiotelevizionin Shqiptar, unë kam përgatitur diçka me shkrim, diçka të shkurtër, koncize, që është më mirë ta lexoj, për atë që unë mendoj dhe për disa problematika që duhen ngritur lidhur me këtë çështje.

Pra, do të thosha si premesë fillestare, sepse është disi e vështirë të flasësh për një institucion, siç është ai i Radiotelevizionit Publik Shqiptar, pa e njohur atë paraprakisht nga brenda, pra të jesh punonjës aty dhe t'i kesh njohur gjërat dhe mangësitë që ai paraqet. Megjithatë, do të thosha se Radiotelevizioni Shqiptar është një aset me vlerë kombëtare. Ai ka historikun e tij nga periudha kur ishte i vetmi mjet informimi për publikun shqiptar, por edhe përgjatë këtyre 30 vjetëve të zhvillimit, në kushtet e konkurrencës me ente të tjera informimi, të lindura dhe të zhvilluara gjatë periudhës së demokracisë. Sigurisht, në kushtet e reja të krijuara, Televizionit dhe Radios publike shqiptare u duhej të përshtateshin me këto kushte, sidomos në drejtim të konkurrencës. Tani ngrihet pyetja: sa e kanë arritur? Do të thosha se arritje gjatë këtyre viteve ka pasur, por me mundësitë ekzistuese që ka pasur realisht, këto arritje, në mendimin tim personal, nuk janë edhe aq mbresëlënëse.

Më poshtë po rreshtoj disa problematika të nxitura nga vetë përvoja ime, si shikues i këtij institucioni informimi publik, por edhe nisur nga krahasime me televizione të tjera me një shikueshmëri më të lartë.

Zhvillimi i Radiotelevizionit Shqiptar gjatë këtyre viteve të fundit, sidomos me futjen e sistemit digjital në transmetim në të gjitha kanalet e tij, në përshtypjen time është bërë pa një plan strategjik të mirëfilltë, pa një synim të qartë se ku kërkohet të arrihet. Procesi i digjitalizimit është parë thjesht si një realizim teknik, pa mbajtur parasysh që ky është një proces, i cili duhet të ketë si synim rritjen cilësore në pikëpamjen e shikueshmërisë, të komercializimit të produkteve të tij. Në mbështetje të kësaj ideje, mund të them se produksionet televizive në Radiotelevizionin Shqiptar janë më tepër të një karakteri sasior sesa cilësor.

Sot të jesh në një televizion publik me një shikueshmëri të lartë dhe konkurrent i televizioneve kryesore private nuk do të thotë të rritësh në mënyrë artificiale numrin e kanaleve apo të emisioneve televizive, por të synosh të krijosh produksione televizive cilësore, edhe pse ato mund të jenë në një numër më të pakët, me gjithë elementet e krijimit të produktit, si, për shembull, studio, produktioni, tematika, moderimi, faqosja grafike, ndryshimi i shpeshtë i logos së Televizionit Shqiptar, 2 herë në 4 vjet, gjë që në mendimin tim është gjithmonë një gabim, sepse logoja është një dhe ajo ngelet, sepse ka një karakter historik, ndërsa në Televizionin Publik Shqiptar logoja ka ndryshuar sipas tekave të drejtorëve të përgjithshëm, thuajse gjithmonë.

Në RTSH vihet re një numër emisionesh shpesh me të njëjtën tematikë në kanale të ndryshme, siç janë emisionet e mëngjesit, 2 të tillë në “RTSH 1” dhe “RTSH 2”, këtë po e them në parantezë, sepse e kam ndjekur gjatë kësaj kohe Televizionin Shqiptar dhe e kam parë me një lloj synimi, dhe shoh që në orën 10:00-10:30 të mëngjesit “RTSH 1”, që është kanali kryesor i Televizionit Shqiptar, jep filma policeskë. Kush i sheh këta filma policeskë në “RTSH 1”, në orën 10:00 të mëngjesit?! Një film të tillë mund ta japësh në darkë, mund ta japësh pasdite, por jo në mëngjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto kanë të bëjnë me një mospërgatitje të mirë të stafit, që bën përzgjedhjen e emisioneve.

Emisionet nuk duhen bërë për të zënë me punë disa moderatorë apo autorë, por me një koncept të qartë tematik, me mision social, piketuar për targetgrupe të ndryshme.

Kjo gjë vlen edhe për emisionet në radio, sepse këtu i kushtohet vëmendje vetëm televizionit, por për mendimin tim radioja është jashtëzakonisht e rëndësishme. Radioja edhe sot në botë merr një vlerë të veçantë, sepse ka njerëz të caktuar, ke fasha spektatorësh që ndjekin radion. Kur je në makinë, për shembull, ndez radion jo vetëm për të dëgjuar muzikë, por edhe diçka tjetër, që të ketë një analizë.

Pra, sa thamë më sipër, vërtetohet më së miri nga *feedback*-u i emisioneve në medien *online*, *You Tube*. Janë emisione të tëra në Televizionin Shqiptar, të cilat kanë një *feedback* minimal. Atëherë, këta njerëz, drejtues të televizionit, ose qoftë edhe ky ent, që quhet Këshilli Drejtues, a e shikon sesa *feedback* kanë emisionet që jep Radiotelevizioni Shqiptar krahasuar me televizionet e tjera? Pra, janë disa problematika që duhen riparë.

Një tjetër problem evident në RTSH, i cili është shitur si arritje, është shtimi pa koncept programativ dhe në mungesë të një arkive të mjaftueshme për numrin e kanaleve televizive.

Televizione publike në Europë, si: “RAI”, “France Television” apo “ZDF” në Gjermani, kanë ndjekur një logjikë. Ato kanë forcuar dhe evidentuar si kanal kryesor të tyre, historikisht, kanalën e tyre të parë, pra “ZDF”, “RAI Uno” dhe “France 2”, për shembull, duke forcuar fillimisht brandin korporativ në përmbajtje, teknologji dhe promovim në “betejën audiovizuale”, në thonjëza, me “RTL Group” në Gjermani, “Mediaset” në Itali dhe “TF1” në Francë, për të kaluar më vonë në shtimin numerik të kanaleve të tjera në platformë. Pra, me këtë dua të them se pa ngritur në nivel, minimalisht një kanal ose dy kanale, nuk mund të shtosh kanale pa fund dhe ta shesësh sot se ke bërë 14 kanale. Bërja e 14 kanaleve nuk çon askund, sepse ato përsërisin njëri-tjetrin. Në qoftë se shikon kanalet televizive të RTSH-së, shpeshherë ka përsëritje pa fund, që të mërzis.

RTSH-ja sot duhet të ketë si qëllim që kanalën autentik dhe kryesor të tij, “RTSH1”, ta kthejë në kanalën më të ndjekur të të gjithë shqiptarëve, duke konkurruar dhe duke lënë pas, pse jo, “Top Channel”, “Klan” apo “Vizion Plus”.

Natyrisht, platforma e RTSH-së, për mendimin tim, duhet të ruajë disa kanale tashmë të krijuara, si “RTSH 2”, “RTSH 24”, “RTSH Kuvend”, i cili kam mendimin se duhet të modernizohet së tepërmi, pra të jepen edhe intervista të deputetëve, pra të jetë një program i tërë për “RTSH Kuvend” apo “RTSH Sport”, por të riformatojë kanale të tilla, si “RTSH 3”, “RTSH Film”, “RTSH Muzikë”, “RTSH Plus”, “RTSH Agro”, shumë i përfoluri “RTSH Agro”, që e kam ndjekur gjatë kësaj periudhe, jep emisione për bujqësinë, gjoja në imitim të *Linea Verde* të “RAI”, ndërkohë që nuk ka tekst, emisionet nuk kanë përkthim, pra fut një bobinë, një kasetë dhe ky qenka televizioni, kanali për bujqësinë! Pra, nga 14 kanale që janë sot, mund të jenë 6 ose 7 maksimalisht, por të saktë dhe të ndjekur.

Problem shumë serioz është investimi në teknologjinë e transmetimit në RTSH. Këtu dua të them diçka që më ka ndodhur personalisht. Kam qenë pjesë emisionesh televizive në RTSH, më specifikisht në emisionin “Bibliotekë” që bën Arta Marku, kur më ka ftuar si përkthyes të librave të ndryshëm. Aty jam stepur, sepse kisha dëgjuar që ky televizion ka bërë investime dhe aty shikoja që kameramanët dritën e rregullonin me një karton për të normalizuar intensitetin e dritës, pra disa problematika janë qesharake. Pra, nuk është investuar, sepse ka munguar një lloj transparence në çështjen e investimit.

Sot Televizioni Shqiptar, të gjithë e shohim dhe kemi mundësinë ta konstatojmë, nuk ka një studio virtuale. Nuk ka televizion modern sot në botë, në Europë, ku duam të hyjmë, që të mos ketë një studio virtuale. Pra, mungon një studio virtuale që ndryshon komplet pamjen nga mbrapa.

Për shembull, “Klan” ose “Top Channel”, në rastin më të mirë, është drejt studios virtuale, ose ka një studio virtuale, por Televizioni Publik Shqiptar nuk ka një studio virtuale, domethënë nuk ka gjallëri, se televizioni duhet të jetë energji, qoftë edhe në mënyrën se si i jep reklamat Televizioni Shqiptar. Pra, Televizioni Publik Shqiptar i jep reklamat në mënyrë të vdekur, nuk i jep me gjallëri, kjo është çështje e specialistëve të këtij televizioni nga mënyra se si i konceptojnë dhe se si i bëjnë, pra kanë mangësi edhe në grafistë. Grafika ka rëndësinë e vet. Një nga kanalet televizive që e kam ndjekur me qejf vite më parë, qysh kur u krijua, ka qenë “Vizion Plus”. Po ta shikosh “Vizion Plus”, në materialin grafik të përgatitur, në mënyrën se si e servir, është shumë më i gjallë se sa Televizioni Shqiptar, ndërkohë që kjo kërkon thjesht disa specialistë, të cilët të dinë se si të punojnë, sigurisht, duke parë edhe nivelin e pagave, se të gjitha gjërat shkojnë bashkërisht.

RTSH-ja sot ka nevojë të investojë në burime njerëzore, profesionale, për sa u përket regjisorëve, skenografëve, redaktorëve të programeve, moderatorëve dhe pjesës së brandit grafik. Këta duhen stimuluar që të krijojnë asete televizive cilësore dhe bashkëkohore.

Thuhet nganjëherë se TVSH-ja ka një lloj “nostalgjie” për ata që kanë punuar dikur. Dakord, ata kanë bërë aq sa kanë mundur dhe në kushtet aq sa ju lejohej, por këta njerëz tani janë plakur, këta njerëz nuk kanë më energjinë e nevojshme që të punojnë dhe të japin në këtë drejtim. Prandaj duhet parë më tepër nga të rinjtë, të cilët janë të formuar, të formatuar, pse jo edhe jashtë shtetit, pse jo duke konkurruar dhe duke i marrë nga televizione të tjera. Në qoftë se ti bëhesh më joshës, ti mund t’i marrësh edhe “Top Channel”-it, edhe “Klan”-it specialistë, ndërkohë që specialistë gjen rregullisht.

RTSH-ja sot duhet të fuqizojë konceptin e saj programatik dhe produktional, duhet të guxojë të lidhë kontrata ose marrëveshje me kompani të mëdha produktioni, si me ENDEMOLIN, për shembull, për formate televizive të suksesshme apo kompani të mëdha filmike, për premiera filmi apo evente të rëndësishme.

Këtu nuk është çështja që vetëm ENDEMOLI (për shembull, *Voice-in* e ka kapur “Top Channel”-i), por ata i shesin të drejtat e tyre... Përse të mos futet edhe Televizioni Publik Shqiptar, se aq para i ka, sa për të blerë një të drejtë? Janë forma, për të cilat Televizioni Shqiptar duhet të ndjekë një politikë më agresive, jo politikën e pritjes, domethënë ata janë më të mirë, dhe kjo më kujton një gjë, sepse unë kam punuar tek INSIG-u për 2 vjet, që INSIG-u ka qenë kompania e parë, e vetme, e sigurimeve në Shqipëri, fillimisht shtetëror, sh.a., nga INSIG-u dolën të gjithë specialistët e sigurimeve të Shqipërisë, pra të gjithë ata, që punojnë sot te SIGAL-i, te SIGMA dhe

në të gjitha këto kompanitë e tjera private, kanë dalë nga INSIG-u. INSIG-un e mbajtën në formën që ishte thjesht dhe vetëm që ta dobësonin sa më shumë, pastaj të kishin mundësi ta privatizonin më lehtë. Këtu po vë gishtin te një problematikë shqiptare, që t'i themi gjërat siç janë, se nuk kemi çfarë të humbasim, po të mos i themi gjërat.

RTSH-ja më duket, pak a shumë, në këtë derexhe, pra që ka mundësi të bëhet më shumë, por kjo RTSH këtu e ka vendin, le të rrijë këtu, pavarësisht se flitet shumë, llafe të bukura ka plot “do të bëjmë një televizion sa më publik, sa më privat, sa më kështu e sa më ashtu”, por, faktikisht, gjërat janë vendnumëro.

E fundit nga radha, por jo nga rëndësia: investimi imediat që duhet të bëjë RTSH-ja është digjitalizimi i arkivit, besoj se është diçka që është ngritur edhe nga të tjerët, i cili përbën një thesar kombëtar televiziv, gjë që do ta kthente RTSH-në në majën e televizioneve shqiptare, aty ku i takon. Në rast se nuk ndërhyhet shpejt, krejt ky arkiv do të pësojë dëmtime të pariparueshme, ndërkohë që digjitalizimi do ta bënte atë shumë të përdorshme, duke shtuar së tepërmi edhe mundësinë e komercializimit të tij për fitime që do t'i shkonin edhe vetë Televizionit Publik Shqiptar. Një gjë e tillë do të kontribuonte së tepërmi në ruajtjen e kujtesës kombëtare për brezat e rinj që e njohin fare pak ose keq të kaluarën e vendit të tyre.

Këto ishin disa gjëra të përgjithshme të mbledhura nga unë.

Faleminderit!

Flutura Açka – Faleminderit!

Ju keni të drejtë për punën e Televizionit Shqiptar, që ka shumë kanale, por ka vetëm një studio qendrore.

Në fakt, në kohën që kam hyrë unë për herë të parë atje, në fillim të viteve '90, ka pasur shumë studio, ka pasur shumë drita, me lejlekë e me çfarë të duash ti, nuk po them se e kishte bërë shumë mirë Enver Hoxha, por, të paktën, kishte diçka që mund ta kishim ruajtur. Se ku kanë shkuar ato drita e ku kanë shkuar ato kamera, një Zot e di, por tani është vetëm një hangar dhe në këtë cep bëhet politika, dhe në këtë cep bëhet programi i mëngjesit, dhe lëvizin ata lejlekët nga të gjithë krahët. Edhe në programin politik, që presupozon një program shumë të rëndësishëm në RTSH, në mes të sheshit, mes ndenjësve, është një blamë e madhe, se linoleumi është prishur, është dëmtuar dhe s'ka kohë kush t'i vërë 1 metër katror linoleum. Ky është Televizioni Shqiptar, për fat të keq, sot.

Pra, duhet shumë punë. Edhe ne po bëjmë fjalë, fjalë, por çfarë do të bëjmë konkretisht me RTSH-në?

Krenar Hajdëri – Ajo ndërtesë, me sa dimë, ai televizion është ndërtuar për ato kërkesa, për atë kohë. Ndoshta, duhet parë mundësia që vetë Televizioni Publik Shqiptar, me të ardhurat që ka, të ndërtojë diçka tjetër për veten e tij, me studio më të mëdha, sepse ekzistuesi ka dalë nga koha, pra nuk është më i përshtatshëm. Ndoshta njerëzve u vjen mirë se e kanë në qendër të Tiranës, por të shikosh “Top Channel”-in apo të tjerë kanë bërë studio diku larg, pra televizionet nuk duhet të kenë frikë nga kjo punë.

Flutura Açka – Inshallah s’po na dëgjon kush, se do të bëjë ndonjë televizion me kullë. Të lutem, aman!

Urdhëroni, zonja Bano!

Eralda Bano – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit, zoti Hajdëri, për prezantimin tuaj!

Unë kam një pyetje të thjeshtë. Duke qenë se ju punoni në Kuvendin e Shqipërisë, a mendoni se keni konflikt interesi për të qenë anëtar i Këshillit Drejtues të RTSH-së?

Faleminderit!

Krenar Hajdëri – Faleminderit për pyetjen!

Unë, përpara se të depozitoja kandidaturën time, kam pyetur për këtë. Këtu, në Kuvend, ka një drejtori monitorimi dhe nuk ka asnjë pengesë në rastin tim konkret, për konflikt interesi e kam fjalën. Unë nuk kam asnjë konflikt interesi, as me projekte, si personat e tjerë që mund të jenë pjesë e KDRTSH-së, që kanë qenë regjisorë në televizione, e ku di unë se çfarë, që punojnë për projekte. Unë, në rast se do të hyj atje, në rast se, pra *if* gjithmonë, do të hyj me mendimin që të jap një kontribut sado minimal edhe lidhur, sepse këtë mundësi e kam, se gjithë jetën kam punuar në drejtimin e marrëdhënieve me jashtë, me vendosjen e kontakteve me disa televizione publike, me këto që kemi më afër, me italianët, për shembull.

Ky grup që është, aktualisht, nuk ka asnjë kontakt, as me televizionin publik francez, as me televizionin italian për të marrë një përvojë si e bëjnë ata ose si e kanë bërë ata. Domethënë, ne thjesht kemi shtuar kanale, sepse kështu na ka interesuar dhe sasia shihet si cilësi.

Flutura Açka – Zoti Hajdëri, faleminderit shumë!

Ju urojmë suksese!

Do t’ju njoftojmë në kohë.

Kolegë deputetë, faleminderit!

Ishte një seancë e gjatë. Kam përshtypjen se situatën e keni, pak a shumë, të qartë, megjithatë ka një propozim zoti Koçi.

Petro Koçi – Në emër të grupit të maxhorancës, kërkoj që çështjen e përzgjedhjes ta shtyjme në një seancë tjetër, sepse ne akoma nuk e kemi të qartë çfarë vendimi do të marrim. Në fakt, është një vendim i vështirë dhe do të na duhet ta peshojmë pak më gjatë.

Flutura Açka – Ju jeni maxhoranca, ju keni votën, kështu që ne nuk vendosim dot, megjithëse për mua situata ishte shumë-shumë e qartë. Megjithatë, ju keni paqartësitë tuaja, retë tuaja, se, normal, jeni në pushtet, keni të drejtë, jeni shumë të ngatërruar, keni shumë qoka për të bërë, por neve i kemi shkurt gjërat.

(Diskutime nga salla.)

E kisha me humor. Një batutë bëra!

Do ta shtyjme për javën tjetër.

Faleminderit!